



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM PERIODIK

Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në

“Fizioterapi”

Universiteti Privat “Albania University ”

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Prof.Dr. Irena KOLA

2. Phd. Aisel OSEKU

Janar/2025

Tabela përmbledhëse për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”

1	IAL aplikues:	Universiteti Privat “Albanian University”
2	Njësia bazë që e ofron:	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë
3	Emërtimi i programit të studimit:	Bachelor në Fizioterapi
4	Urdhëri/VKM i licencimit:	UMASH Nr. 199, datë 16.05.2012
5	Urdhëri/VKM i riorganizimit:	Shkresë MASR Nr. 4932/I prot, datë 05.06.2018.
6	Forma e regjistrimit të diplomës:	Urdhër QSHA Nr. 387, datë 28.10.2020.
7	Urdhëri/VBA i akreditimit të parë:	VBA Nr. 110, datë 02.11.2019
8	Cikli i studimit:	Cikli i dytë
9	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
10	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
11	Forma e studimit:	Kohë e plotë
12	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
13	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera:	Jo
14	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	Jo
15	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	Jo
16	Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve:	Niveli 6 i kornizës kombëtare të kualifikimeve
17	Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit:	2021-2022 42 PAE/ 43PAK 2022-2023 42 PAE / 51 PAK 2023-2024 55 PAE/ 36 PAK
18	Numri i studentëve:	2021-2022; 68 studentë 2022-2023; 51 studentë 2023-2024-; 39 studentë
19	Komente / të tjera:	



PËRMBLEDHJE E TË DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” është hapur në vitin akademik 2011–2012. Ky program studimi ofrohet në Fakultetin e Shkencave Mjekësore, që u hap me Urdhër Nr. 199, datë 16.05.2012. Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” synon: përgatitjen e specialistëve me njohuri të përgjithshme në fushën e fizioterapisë, në drejtimin e menaxhimit individual dhe në grup si dhe të njohë dhe të përdorë teknologjinë e aplikuar në praktikën e terapisë manuale, rehabilitimit dhe terapisë ushtrimore nëpërmjet lëvizjes. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me formë studimi me kohë të plotë, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë e “Ciklit të Parë” Bachelor në “Fizioterapi”. Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” krahas formimit specifik në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit, ofron edhe formim të përgjithshëm metodologjik e kulturor të studentëve, për të formuar kështu krahas specialistit të shëndetit edhe qytetarin. Kështu, studentët marrin një formim bazë në lidhje me aspekte akademike e metodologjike, por edhe elementë të kulturës së përgjithshme (përmes lëndëve si bioetikë, psikologji, informatikë, terminologji-gjuhë e huaj, etj). Programi është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Të kombinuara së bashku këto dimensionet e pajisin studentin në Bachelor me njohuri të përgjithshme dhe disa aftësi bazë në lidhje me punën apo specializimin e mëvonshëm si specialist në fushën e fizioterapisë.



PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;

Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, vendosën një Grup ekspertësh: **Prof.Dr. Irena KOLA** dhe **Phd. Aisel OSEKU**, si ekspertë të jashtëm të vlerësimit për këtë program studimi. Në përzgjedhjen e anëtarëve të Grupit është mbajtur parasysh kompetenca profesionale, përvoja mësimdhënëse, aftësitë analizuese, për përpunimin e informacionit për të kryer një vlerësim të paanshëm, shkalla e nevojshme të njohjes së institucionit, si dhe profili individual profesional. Në punën për hartimin e Raportit, Grupi ka vepruar me një ndarje pune, detyra dhe përgjegjësi të përcaktuara qartë për secilin anëtar. Në ditët e vizitave në institucion u planifikua më parë një radhë pune si: konsultim me personelin akademik dhe studentët, me anëtarët e GVB, sekretarinë etj. GVJ është bazuar në kërkesat e Ligjit Nr. 80/2015, datë 22.07.2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, aktet ligjore e nënligjore përkatëse, në mënyrë të veçantë ka shfrytëzuar dokumentet e brendshme të Albanian University. Grupit i janë vënë në dispozicion çdo lloj dokumentacioni i kërkuar dhe ka shfrytëzuar për këtë vlerësim në mënyrë racionale të dhënat që nevojiten për të bërë të mundur procesin e vlerësimit të jashtëm. Ecuria e procesit të vlerësimit të jashtëm është ndjekur dhe mbikëqyrur nga koordinatori teknik Msc.Anilda Beqiraj, si përfaqësuese e ASCAL, e cila ka koordinuar procesin e mbledhjes së të dhënave. GVJ-ja ka zhvilluar takime me të gjithë aktorët e përfshirë në këtë proces. Gjatë takimit u miratua plani i punës, hapat dhe afatet deri në dorëzimin e draftit përfundimtar të raportit të vlerësimit të jashtëm.



SHKALLA E PERMBUSHJES SË REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I FUNDIT

I. Rekomandimet e Bordit të Akreditimit mbështetur në Vendimin Nr.110, datë 02.11.2019 janë:

- Institucioni të rrisë mbështetjen e tij financiare për përfshirjen e stafit akademik të këtij programi studimi në veprimtari kërkimore shkencore, trajnime e kualifikime shkencore, veçanërisht jashtë shtetit.
- Institucioni, të shtojë titujt e literaturës së huaj për këtë program studimi.

II. Plotësimi i rekomandimeve nga Institucioni

Rakomandimi i parë përmbushet plotësisht

- Me qëllim ruajtjen e cilësisë dhe stimulimin e stafit, Albanian University ka akorduar një fond të veçantë për mbështetjen financiare të aktiviteteve shkencore të stafit. Nga vizita në institucion u informuam që në mbështetje përfshihen shpenzimet e publikimeve dhe shpërblime për autorët (Evidence R.1.a.b.c.d).
- Bazuar në këtë procedurë për vitet akademike 2019 - 2024 në Departamentin e Infermierise dhe Fizioterapisë ka patur tre pedagoge/4 artikuj përfitues të granteve për financimin e publikimit si dhe shpërblime financiare për autorët e parë dhe të dytë (Evidence R.1.e).

Rekomandimi i dytë përmbushet plotësisht

- Përsa i përket shtimit të titujve të literaturës së huaj në këtë program studimi Albanian University në çdo vit akademik rinfreskon listen e literaturës së huaj si dhe pasuron bibliotekën me zëra të rinj kombëtar dhe ndërkombëtar (Evidence R.2.a).

Universiteti Privat AU është njohur me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 12.12.2024, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr Prot 317/21, datë 12.12.2024. Institucioni njofton në ASCAL më datë 19.12.2024, nëpërmjet shkresës me Nr Prot 469/1, datë 19.12.2024. *Kthim përgjigje mbi DRVJ e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi".*

Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”

I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMEVE

Standardi I.1 Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësish kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	Nga dokumentacioni mbështetës u konstatua se programi i studimit është në harmoni me interesat kombëtare dhe me misionin e Albanian University të parashikuar në nenin 7 të Rregullores të AU-së. <i>Ref. Nr. 1.3.a. Rregullore e Albanian University, Plani i Zhvillimit Strategjik, neni 7.</i>
Kriteri 2. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi i shërben më së miri misionit të vet, por edhe misionit të AU-së, për të përgatitur specialistë në fushën e fizioterapisë, për parandalimin, trajtimin dhe rehabilitimin e pacientit. <i>Ref. Nr. 1.1.b, Statuti i Albanian University, Misioni, neni 3; Ref. Nr. 1.3.a, Rregullore e Albanian University, Plani i Zhvillimit Strategjik, neni 7.</i>
Kriteri 3. Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.	Programi i studimit “Bachelor në Fizioterapi” është hartuar dhe funksionon në përputhje, në përshtatje të plotë dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim të AU-s. Ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përshtatje me fushat dhe drejtimet e Institucionit si dhe në bazë të akteve dhe vendimeve të brendshme të tij. Sipas planit strategjik të AU-së, ky institucion synon të mbetet model i arsimit të lartë privat i karakterizuar nga përgatitje rigoroz akademike dhe kërkim i thelluar. AU është përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit në fushën e fizioterapisë, rehabilitimit si dhe menaxhimit shëndetësor. <i>Ref. Nr. 1.3.a, Rregullore e Albanian University, Plani i Zhvillimit Strategjik, neni 7, Ref. Nr. 1.1.b, Statuti i Albanian University, Ref. Nr. 1.3.a, Rregullore e Albanian University, Ref. 1.4.a, Plani Strategjik Institucional AU 2023-2028), si dhe me fushat e drejtimit akademike të tij.</i>
Kriteri 4. Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë.	Albanian University dhe Fakulteti I Shkencave Mjekësore kanë përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike që lidhet me studimet e ciklit të parë “Bachelor” në “Fizioterapi”. AU dhe FSHM në vitet e fundit kanë rritur kontributin e tyre duke rritur kapacitetet e njerëzore duke u fokusuar në fushën e rehabilitimit dhe fizioterapisë nga viti 2019-2024. Programi i studimit është hartuar në

	përputhje me nevojën e tregut të punës për specialistë që të punësohen në qendrat e rehabilitimit, në qendrat e mjekësisë sportive dhe klinikat e fizioterapisë, ekipet sportive, spitalet publike dhe private, çka nxit pashmangshmërisht në zhvillimin e fizioterapisë në rang lokal e kombëtar. <i>Ref. Tabela 1, 1.1, 1.2, 1.3, 1.4, 1.5 Stafit akademik PAE dhe PAK përgjegjës për programin e studimit Bachelor në Fizioterapi.</i>			
Kriteri 5. Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore / bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit është në përputhje të plotë me fushën akademike e kërkimore të AU-së dhe Departamenti Infermieri dhe Fizioterapi, i cili është përgjegjës për programin e ciklit të parë të studimit “Bachelor” në “Fizioterapi”. AU dhe FSHM, e kanë bazuar programin e studimit sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. <i>(Ref. 1.8. Ministria e Arsimit dhe Sporti. Udhëzim Nr. 31, dt 15.11.2022, Nr. 7556/1. Prot, Udhëzim për procedurat për kodifikimin e programeve të studimit të ofruara nga IAL në RSH)</i>			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” që ofrohet nga Albanian University (AU) është në harmoni me interesat kombëtare si dhe misionin dhe objektivat e IAL-së. Programi ofrohet bazuar në aktet ligjore e nënligjore si dhe aktet e hartuara dhe miratuara nga vet institucioni.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi I.2

Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, kërkimit shkencor dhe mobilitetit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësisë përkatëse dhe	Gjatë vizitës konstatuam që Institucioni është organizuar në njësi kryesore dhe njësi bazë konform legjislacionit në fuqi. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësisë midis njësive të ndryshme është e rregulluar po kështu me anë të dokumenteve ligjore përkatëse në rang universiteti dhe në rang fakulteti, si Statuti i AU-së. Paralelisht, Njësia Kryesore ka strukturat ndihmës akademike si në nivel Fakulteti ashtu dhe në nivel Departamenti. Qëllimi i tyre është bashkëpunimi dhe koordinimi për ofrimin e programeve të studimit.

analizës së vazhdueshme të punës së tyre.	(Ref. 1.1.b. Statuti i AU) dhe (Ref. 1.1.a). Rregullorja e AU-së (Ref.1.3. Rregullore e AU-së) dhe Rregullorja e FSHM- së (Ref.1.5.Rregullorja e FSHM-së: Ref. 1.6 Rregullore e Departamentit të Infermierisë dhe Fizioterapisë).
Kriteri 2. Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj.	Bashkëpunimi me IAL vendase e të huaja është një nga prioritetet strategjike të AU. Me qëllim zhvillimin e procesit mësimor dhe formues të studentëve, ku Albanian University ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione publike/private brenda dhe jashtë vendit. Këto bashkëpunime fokusohen në zhvillimin e leksioneve, praktikave apo bashkëpunimeve për projekte kërkimore edhe/ose zhvillimore. Në bazë të dokumentave të dorëzuara, AU ka lidhur marrveshje bashkëpunimi me IAL vendase dhe të huaja përfshirë këtu Institucione nga Rumania, Austria, Italia etj. Në takimet e zhvilluara me Drejtuesin e Njesisë Kryesore dhe atë Bazë, u raportua se ndërkombëtarizimi dhe bashkëpunimi me Institucione të huaja është një prioritet për ata. Ref.1.4.a. Plani Strategjik i Zhvillimit të AU, 2021-2026 Ref. Nr.1.1.b. Statuti i AU, neni 6, neni 7, neni 11 Ref. Nr. . Tabelat përmbledhëse Ref.1.11. Marrëveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja Ref.1.12. Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.
Kriteri 3. Për realizimin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme me institucione, institute kërkimore, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës apo stazhit etj.	Me qëllim realizimin e programit të studimit, AU ka nënshkruar marrveshje bashkëpunimi me qendra të ndryshme rehabilitimi, klinika private si dhe institucione të ndryshme kombëtare, përfshirë këtu Spitalin Universitar të Traumës, Poliklinika e Specialiteteve etj. Këto marrveshje u japin mundësinë studentëve të zhvillojnë pjesë të programit të tyre mësimor (praktika). Ref. Nr. . Tabelat përmbledhëse Ref. 1.11. Marrëveshjet me Spitalet dhe Klinikat private për realizimin e praktikave. Ref. 2.4. Dosja e praktikës për programin e studimit Bsc, në Fizioterapi.
Kriteri 4. Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit.	Njësia Bazë në bazë në legjislacionin në fuqi harton raportin vjetor i cili bën pjesë në raportin e Njesisë Kryesore dhe në të cilin përfshihen edhe bashkëpunimet e ndryshme. Në këtë raport përfshihet edhe një relacion mbi zhvillimin e praktikave klinike të studentëve. Nga drejtusi i njesisë bazë na u raportua se hartimi dhe nënshkrimi i marrveshjeve zhvillohet në bazë të nevojave të institucionit dhe jo thjesht për të rritur numërin e marrveshjeve. GVJ sugjeron se në raportet e ardhshme është e nevojshme përfshirja e një sektori specifik me rezultatet konkrete të marrveshjeve aktive (si psh. ecuria, problematikat etj.). Ref. 1.9. Raport Vjetor Institucional 2022-2023 Ref. 1.10.a. Raport vjetor njësie bazë
Konkluzione	Bashkëpunimi me IAL vendase e të huaja është një nga prioritetet strategjike të AU-së. Me qëllim zhvillimin e procesit mësimor dhe

	formues të studentëve, duke vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me Institucione publike/private brenda dhe jashtë vendit. Këto marrveshje u japin mundësinë studentëve të zhvillojnë pjesë të studimeve të tyre (praktika). <u>Nuk u prezantua një raport konkret mbi implementimin e këtyre marrveshjeve dhe GVJ konsideron si të rëndësishme dicka të tillë në të ardhmen.</u>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

Standardi II.1 Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore kombëtare në fuqi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).	Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" është i organizuar në lëndë e module. Të gjitha këto janë përcaktuar në bazë të legjislacionit në fuqi si dhe të Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve. Për të përmbyllur këtë program studimi, studentët duhet të mbledhin 180 kredite (ECTS) në total. Numri i krediteve për lëndë varion ndërsa provimi përfundimtar ka 6 kredite. <i>Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit;</i> <i>Ref. Nr. 1.3.b, Rregullorja e Albanian University korrik 2023, neni 55;</i> <i>Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor i programit të studimit, Bachelor në "Fizioterapi";</i>
Kriteri 2. Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionale e specialitetesh, jep njohuri të përparura në një fushë studimi ose punësimi, ku	Programi i studimit "Bachelor" në "Fizioterapi", i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë bazë shkencore dhe praktike në fushën e fizioterapisë. Kursi i studimit, synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit dhe ka për qëllim të formojë profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga semundje të ndryshme, llojet me kryesore të dëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe permiresimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme,

përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.

dëmtimeve sportive; dhe rehabilitimin nga semundje të ndryshme kronike si rehabilitim kardial për pacient me semundje kardiovaskulare, rehabilitim fizik për të gjitha llojet e dëmtimeve të aparatit muskuloskeletor, etj. Plani mësimor përfshin zhvillimin e lëndëve me karakter teorik si dhe praktikë mësimore. Kombinimi i teorisë me praktikën u jep studentëve mundësinë të zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca në fushën e fizioterapisë. Të gjitha këto u japin mundësinë të zgjidhin probleme komplekse në këtë fushë specifike me qëllim ushtrimin e profesionit në të ardhmen në mënyrë sa më të mirë.

Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit;

Ref.3.19. Model Diplome të programit të studimit Bsc në Fizioterapi; Ref. 2.11. Model, Syllabusi i lëndës;

Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor i programit të studimit, Bachelor në "Fizioterapi".

Kriteri 3. Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.

Programi i studimit ka në total 180 kredite (ECTS). Lëndët/modulet janë të ndara në pesë kategori ku përfshihen lëndë bazë (19% e krediteve), lëndë karakterizuese (51% e krediteve), lëndë ndërdisiplinore/integruese (13% të krediteve), lëndë plotësuese (10-15% të krediteve dhe detyrime përmbyllëse (3% të krediteve). Në cdo vit akademik studentët mund të marrin 60 kredite në total (30 në secilin semestër). Secili kredit është i barabartë me 25 orë mësimore (përfshirë këtu leksione, seminare, detyra etj.).

PLAN! MESIMOR per programin e studimit .Bachelor ne' Fizioterapi		
Tipi i Veprimtarisë (A-F)	Undet/Modulet	Kredite/ECTS
LENDE BAZE' - pergatitje metodologjike dhe kulture e pergjithshme (A) 15% - 20% (kredite)	Anatomi Nonnale	6
	Fizike	3
	Biofizike	3
	Statistike	3
	Neuroanatom	6
	Histologji	5
	Fiziologji	5
LENDE KARAKTERIZUESE - pergatitje per disiplinen shkencore (B) 50% - 55% (kredite)	Princioet e U'vizieve	6
	Vleresimi NeuroFiziologjik	6
	Neurologji	6
	Rehabilitim Neurologjik	6
	Ortopedi	6
	Imazheri	4
	Prostetike	6
	Rehabilitim Ortopedik	6
	Urgjence	3
	Rehabilitim Prostetik	6
	Masazh Mobilizim Manipulim	6
	Rehabilitim Pediatrik	7
	Shendet Sportist, Rehabilitim ne Sport	6
	Semundje te Brendshme	6
	Geriatri dhe Rehabilitim Geriatrik	6
	Fizioterapi Instrumentale	4
	Rehabilitim Kardiopulmonar	6
	Rehabilitim Fizik	6



		LE'NDE NDERDISLPLINORE/ INTE GRUESE nendisiplina, profile dhe grup-lende me zgjedhje (C) 12% -15% (kredite)	Infennieristike e Pergjithshme	5
			Farmakologji	5
			Lende me zgjedhie	6
		LENDE PLOTESUESE- gjuhe e huaj, njohuri informatike, praktika profesionale (D) 10-15% (kredite)	Infonnatike	3
			Anglisht	4
			Praktikl' Profesionale 2.1	4
			Praktike 2.2	7
			Praktike Profesionale 3.1	3
			Praktike Profesionale 3.2.	4
		DETYRIME PERMBYLLESE (E) 3%-5% (kredite)	Provimi Perfundimtar	6
		Totali	180	
		Ref. 2.1. Rregullorja e Programit te Studimit:		
		Ref. Nr. 1.3.b, Rregullorja e Albanian University korrik 2023, neni 55; Ref.		
		2.2. Model, Plan Mësimor i programit të studimit, Bachelor në "Fizioterapi".		
Kriteri 4. Programi i studimit ka të përcaktuara ngarkesën në kredite për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse.	Ky program studimi është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të gjitha VKM-të dhe udhëzimet specifike të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit. Totali i krediteve për këtë program studimi është 180 ECTS. Sipas parashikimeve në planin mësimor, Praktika 2 dhe Praktika 3 ka 8 kredite secila, ndërsa praktika 1 pesë (5) kredite. Studentët (sipas nenit 15 pika 1 e Rregullores së Programit) kanë detyrimin e kryerjes 100% të orëve të praktikës mesimore. Studentët më qëllim përfundimin e sukseshëm të këtij program studimi janë të detyruar të japin provimin përfundimtar i cili ka 6 kredite. Në bazë të Nenit 20 të progrmit të studimit, studimet e ciklit të parë "Bachelor në "Fizioterapi", përmbyllen me provim të përgjithshëm përfundimtar dhe në përfundim të tyre lëshohet diploma në "Fizioterapi". Studenti nuk mund të futet në provimin final pa shlyer më parë të gjitha detyrimet dhe pa fituar numrin e krediteve të parashikuara në planin mesimor. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor ne "Fizioterapi".			
	Ref. 2.1. Rregullorja e Programit te Studimit; Ref. Nr. 1.3.b. Rregullorja e Albanian University korrik 2023, neni 55; Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor i programit të studimit. Bachelor në "Fizioterapi".			
Kriteri 5. Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e	Sipas statutit të AU-së (neni 48), format e studimit janë me kohë të plotë dhe kohë të zgjatur ndërsa pranimi i studentëve zhvillohet me vendime të brendshme të Institucionit. Pas propozimeve nga Njësia Bazë, Senati Akademik miraton kuotat e pranimeve të cilat duhet të jenë në përputhje me standartet e përcaktuara. Kuotat e pranimi llogariten mbi bazën e studentëve aktivë që ndjekin programet e studimit. AU miraton kriteret e pranimi për studentët në bazë të legjislacionit në fuqi. Financimi i UST zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi.			

arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara me udhëzim të ministrisë përgjegjëse për arsimin.	Ref. 1.1.a. 1.1.b. Statuti i AU i miratuar korrik 2023, neni 48; Ref. 2.8. Vendim i Senatit për miratimin e kuotave të pranimit për programin.			
Kriteri 6. Programet e studimit Bachelor, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, cikël si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind.	Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi është i ngjashëm në nivel më të lart se 70% me programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” i cili ofrohet nga Universiteti i Mjeksisë, Fakulteti i Shkencave Mjekso-re Teknike, Tiranë. Për hartimin e këtij program studimi u morr parasysh program i FSHMT si dhe programe të ngjashme jashtë Shqipërisë. Paralelisht, programe të ngjashme të cilat ofrohen në Universitete Europiane janë marrë parasysh për hartimin e këtij programi. Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor i programit të studimit, Bachelor në “Fizioterapi”;			
Kriteri 7. Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit.	Kodifikimi i programit është në proces dhe nuk është përfunduar akoma. Në përfundim të kodifikimit të programeve të studimit në rang kombëtar, do të kodifikohen respektivisht dhe lëndët/modulet në këtë program studimi. Ky proces nuk është përfunduar pasi pritet realizimi i tij nga MAS, bazuar edhe në udhëzimin e publikuar. Takim me Dekanin/Drejtuesin e Departamentit; Ref. Nr. 1.8. Kodifikimi i programeve të studimit. (Propozim për kodifikim).			
Kriteri 8. Programet e studimit mund të jenë edhe programe të përbashkëta midis dy ose më shumë institucioneve të arsimit të lartë, vendas dhe të huaj, në përputhje me legjislacionin në fuqi.	Ky nuk është një program i përbashkët. Në bazë të Rregullores së Njesisë Kryesore, ofrimi i programeve të përbashkëta është një nga objektivat e AU-së. Për këtë arsye, AU ka nënshkruar marrveshje bashkëpunimi me Institucione publike dhe private si brenda ashtu dhe jashtë vendit. Kjo është dhe një nga Prioritetet Strategjike (Nr. 5 – Ndërkombëtarizimi) të AU-së. Gjatë vizitës në Institucion, u informuam nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore se po punohet në këtë drejtim për ofrimin e programeve të përbashkëta. Ref. Nr. 1.4.b.. Plani strategjik i zhvillimit institucional 2023-2028; Ref. Nr. 1.3.b. Rregullorja e AU-së. Ref.1.11. Marrveshje bashkëpunimi me Universitete të huaja Tabelat përmbledhëse			
Konkluzione	Programi i studimit Bachelor në Fizioterapi është i organizuar në lëndë e module. Ky program zgjat tre vite akademike dhe ka në total 180 kredite (ECTS). Ky program është hartuar në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe të gjitha VKM-të dhe udhëzimet specifike...			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.2 Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin.	Sipas dokumentave në RVB, me Vendim Nr.0.1, datë 24.01.2020 të Bordit të Akreditimit, Albanian University është akredituar në nivel Institucional për 6 (gjashtë) vite duke përmbushur kërkesën ligjore për akreditim institucioni. Njësia kryesore përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit është Fakulteti i Shkencave Mjekësore i cili, duke qenë i organizuar në 3 departamente si më poshtë plotëson kriteret e kërkuara sipas kuadrit ligjor në fuqi sipas të cilit një Fakultet organizohet në të paktën tre njësi përbërëse nga të cilat të paktën dy janë departamente. 1. Departamenti i Stomatologjisë 2. Departamenti i Farmacisë 3. Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë Departamenti për vitet akademike 2021- 2024 është i përberë nga Personeli Akademik Efektiv (PAE) në nivel fakulteti (pedagogë PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), të cilët kanë kualifikimin si më poshtë. 1.Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 108 pedagogë nga të cilët 42 PAE dhe 43 PAK dhe 14 staf ndihmes akademik (49% /51 %); 2.Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 108 pedagogë nga të cilët 42 PAE dhe 51 PAK dhe 13 staf ndihmes akademik (45%/55 %); 3.Për vitin akademik 2023 - 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 118 pedagogë nga të cilët 55 PAE dhe 36 PAK dhe 15 staf ndihmes akademik (60% /40 %) Ref.5.Tabelat përmbledhëse
Kriteri 2. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik	Departamenti i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ofron këtë program studimi ka në përbërjen e vet 1 personel ndihmës akademik i cili asiston në ofrimin e këtij program studimi. GVJ sugjeron rritjen e numrit të personelit ndihmës akademik. Ref.5.Tabelat përmbledhëse



/administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj.				
Kriteri 3. Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij.	Sipas Rregullores së Njesisë kryesore përcaktohen të gjitha dispozitat dhe detyrimet e koordinatorit të programit të studimit. Ky person i cili duhet të jetë anëtar efektiv i departamentit propozohet nga Drejtuesi i Njesisë Bazë dhe emërohet/shkarkohet nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore. Me vendimin Nr.Prot 1061 datë 04.10.2023. është marrë vendimi nga Drejtuesi i Njesisë Kryesore për koordinatorin e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”.			
Konkluzione	Ref. Nr. 1.5. Rregullorja e Fakultetit Shkencave Mjekësore, Ref. 2.5. Vendimi për emërimin e koordinatorit të programit të studimit; Departamenti i Shkencave i Infermierisë dhe Fizioterapisë i cili ofron këtë program studimi i përmbush të gjitha detyrimet sipas përcaktimeve ligjore e nënligjore. Departamenti ka në përbërjen e vet staf akademik me kohë të plotë dhe me kontrat si dhe staf administrativ. Paralelisht, në Rregulloren e Njesisë Kryesore përcaktohen detyrimet dhe përgjegjësitë e koordinatorit të programit të studimit. Rritja e numërit të stafit ndihmës akademik si dhe përfitimi i titujve akademik nga anëtarët e Departamentit është e nevojshme.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.3

Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi. Në vizitën e zhvilluar në Institucion u raportua se pranë Njesisë Bazë disponohet i gjithë dokumentacioni i nevojshëm përfshirë këtu planin mësimor, syllabuset, tezat e provimeve etj.
Kriteri 2. Programi i studimit përmban planin mësimor, ku përfshihet informacioni i nevojshëm për ndarjen e lëndëve në semestra, ngarkesën mësimore të	Programi i studimit përmban të gjithë informacionin e nevojshëm. Ky program studimi ka 180 ECTS të ndara në tre vite (60 kredite në vit – 30 kredite për semestër). Informacion mbi ngarkesën mësimore, modulet, orët në auditor dhe jashtë tij janë të detajuara. Plani mësimor për programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi” është i ndarë në

lëndëve/moduleve, orët në auditor/jashtë auditorit.	lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrimet përmbledhëse. <i>Tabelat përmbledhëse;</i> <i>Ref. Nr. 2.1. Rregullore e Programit të studimit Bsc. Në Fizioterapi;</i> <i>Ref. 2.2. Model. Plan Mësimor 2021-2022. Bachelor në "Fizioterapi";</i>			
Kriteri 3. Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.	Në rregulloren e programit të studimit (neni 10) përfshihen të gjitha kriteret dhe procedurat specifike për pranimin e studentëve. Nenet 6-10 detajojnë të gjitha procedurat për transferimin e studimeve dhe njohjen e krediteve. Institucioni, në bazë të propozimeve të Njesisë Bazë miraton kriteret e pranimit dhe i publikon ato. Informacion mbi transferimin e studentëve përfshihen po ashtu edhe në rregulloren e Institucionit (neni 37) si dhe në rregulloren e Njesisë Kryesore (neni 32). Deri në këtë moment nuk ka patur transferime apo ekuivalente të studimeve. <i>Ref. Nr. 2.1, Rregullore e Programit të studimit;</i> <i>Ref. Nr. 1.3.b, Rregullorja e AU-së;</i>			
Kriteri 4. Programi i studimit përmban informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset) për secilën lëndë për praktikën, seminarin apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.	Programi i studimit përmban të gjitha informacionet e nevojshme për syllabuset, për praktikën mësimore, seminarin, punën individuale etj. Të gjitha këto janë në koherencë dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Syllabuset janë të hartuara në bazë të udhëzimit përkatës. <i>Ref. Nr. 2.1, Rregullore e Programit të studimit;</i> <i>Ref. 2.11. Model Programi Lënde.</i>			
Kriteri 5. Përmbajtja e programit të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.	Ky është një program i ri studimi dhe studentët do të diplomohen për herë të parë këtë vit akademik. Në diskutimet e zhvilluara me Drejtuesit e Njesisë Kryesore/Bazë si dhe me pedagogët e programit, ata raportuan se rregullisht e shikojnë përmirësimin e programit si dhe në raportin vjetor përfshijnë informacionin e duhur. Paralelisht, ata na informuan se në fund të diplomimit me ndihmën e alumnit do të shikojnë rregullime të ndryshme që programi mund të ketë nevojë.			
Konkluzione	<i>Njësia Bazë disponon të gjithë informacionin e nevojshëm për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e këtij programi studimi.</i> <i>GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. "Q. Stafa", Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave, mundësojnë, thellim të njohurive dhe aftësive për studime të mëtejshme dhe/ose punësimin e studentëve.	Ky është një program i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë të pajisur me shprehinë bazë shkencore dhe praktike në fushën e fizioterapisë. Diploma në "Fizioterapi", synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e fizioterapisë dhe rehabilitimit, për qëllim të formojë fizioterapist profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që risin rrezikun për tu prekur nga semundje të ndryshme, llojet më kryesore të dëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe përmirësimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme, rehabilitimit pas dëmtimeve apo traumave të ndryshme fizike si aksidenteve në punë e jashtë punës, dëmtimeve sportive; etj. Në këtë moment nuk ofrohet një master shkencor për vazhdimin e studimeve por gjatë takimeve na u konfirmua se studentët pas përfundimit të studimeve do të kenë mundësinë të vazhdojnë studime të ciklit të dytë Master Profesional të cilat do ti ofroj Institucioni në këtë fushë. Ref. Nr. 2.1, Rregullorja e programit të studimit Bsc, në Fizioterapi.
Kriteri 2. Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxënit.	Plani mësimor mundëson arritjen e objektivave formues të programit të studimit. Plani mësimor është i ndarë në lëndë/module me kredite specifike. Në syllabuset e lëndëve përcaktohen qartë kreditet dhe orët brenda dhe jashtë auditorit, objektivat e përgjithshme dhe specifike si dhe rezultatet e pritshme të të nxënit. Ndërthurja e lëndëve të përgjithshme me lëndët më specifike klinike shpërndarja në vite e semestra, mundësojnë formimin profesional dhe shkencor të studentëve. Ref. Nr. 2.1. Rregullore e Programit të studimit Bsc, në Fizioterapi. Ref. 2.2. Model, Plani Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Fizioterapi"; Syllabuset e moduleve/lëndëve të këtij program studimi;
Kriteri 3. Struktura e programit, lëndët, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit të studimit dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Në programin e studimit rezulton, se raporti teori praktikë është i përafërt me programet ndërkombëtare. Gjatë takimit me stafin drejtues dhe akademik u deklarua se programi është i njëjtë me programe të ngjashme ndërkombëtare dhe kombëtare, U deklarua se ky program është i ngjashëm me programin e Fizioterapisë në Universitetin e Mjeksisë si dhe me programe të ngjashme. Në total ky program studimi përfshin: - 1335 orë leksione; - 334 orë seminare;

	- 212 orë ushtrime/detyra kursi; - 700 orë laborator dhe praktikë e klinikë profesionale; - Orët totale në auditor në javë 137 ndërsa ato për studim individual në javë 158.7. Ref. Nr. 2.1. Rregullore e Programit të studimit Bsc, në Fizioterapi. Ref. 2.2. Model, Plani Mësimor 2021-2022, Bachelor në “Fizioterapi”; Syllabusët e moduleve/lëndëve të këtij program studimi;;
Kriteri 4. Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	Plani mësimor i programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi” përfshin veprimtari formuese dhe plani mësimor parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmblledhëse midis formimit teorik dhe praktik duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në fushën e fizioterapisë. Transferimi i studimeve është i mundur ndërsa mobilitetet jashtë Shqipërisë në këtë program studimi mund të realizohen. Institucioni raportoi se në këtë vit akademik do të ndjekin procedurat për mobilitet dy studentë në këtë program studimi, ashtu siç kanë zhvilluar për programet e tjera të cilat ofron dhe ka një numër të konsiderueshëm mobilitetesh. <i>GVJ konsideron si të rëndësishme mobilitetin e studentëve jashtë Shqipërisë dhe beson se IAL-ja duhet të punoj më fort drejt këtij drejtimi për këtë program studimi.</i> Ref. Nr. 2.1. Rregullore e Programit të studimit Bsc, në Fizioterapi. Ref. 2.2. Model, Plani Mësimor 2021-2022, Bachelor në “Fizioterapi”; Syllabusët e moduleve/lëndëve të këtij program studimi;
Kriteri 5. Syllabusët (programet e lëndëve /moduleve) përditësohen në mënyrë të vazhdueshme për marrjen e kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës, duke përfshirë literaturën bazë dhe ndihmëse të viteve të fundit.	Gjatë takimit në Institucion u raportua se syllabusët rishikohen në fillim të çdo semestri akademik. Ato miratohen nga titullari i lëndës dhe më pas nga drejtuesi i departamentit. Literatura e përfshirë u raportua se është ajo e 5-10 viteve të fundit. Pedagogët raportuan se është e vështirë të gjendet literature në gjuhën shqipe dhe se në rastet më të shumta ata u përcjellin studentëve leksionet e prezantuara ne ppt, si dhe detajime të leksionit në formë word/pdf. Kjo procedurë u raportua dhe nga studentët e këtij programi studimi. Ref.2.11. Model Syllabusi;
Kriteri 6. Përmbajtja e programit të studimit garanton përfitimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara.	Përmbajtja e programit synon të ndihmojë studentët në përfitimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim arritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat duhet të përputhen me përmbylljen e ciklit të parë. Përmbajtja e programit synon të ndihmojë studentët në përfitimin e dijeve, të cilat kanë si qëllim rritjen e aftësisive dhe kompetencave, të cilat duhet të përputhen me përmbylljen e ciklit të parë. Modulet/lëndët e përfshira në këtë plan mësimor u garantojnë studentëve të përfitojnë dije, aftësi

	dhe kompetenca të cilat ata do ti ushtrojnë gjatë punësimit të tyre. Të gjitha syllabuset e dorëzuara përfshinin në përmbajtjen e tyre objektivat e mësimnxënies si dhe aftësitë dhe kompetencat e synuara. Si përfundim synohet që studenti të përvetësojë njohuri shkencore, aftësi praktike dhe klinike. Të gjitha këto janë në unison me objektivat e programit të studimit. Ref. Nr. 2.1. Rregullore e Programit të studimit Bsc, në Fizioterapi. Ref. 2.2. Model, Plani Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Fizioterapi"; Syllabuset e moduleve/lendëve të këtij program studimi;			
Kriteri 7. Përmbajtja e programit të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.	Gjatë takimit në Albanian University u vërejt që institucioni nuk dispononte rezultate mbi punësimin apo vijimin e mëtejshëm të studimeve nga studentët. Gjithashtu institucioni nuk dispononte një listë apo një tabelë përkatëse për të gjithë fizioterapistët e diplomuar të cilët pas mbarimit të studimeve në Albanian University rezultonin të licensuar nga Urdhri i Infermierit të Shqipërisë. ;			
Konkluzione	<i>Ky është një program studimi i cili zgjat tre vite akademike, ka si objektiv të formojë profesionistë në fushën e fizioterapisë. Plani mësimor i programit të studimit parashikon lëndë bazë, karakterizuese, ndërdisiplinore, plotësuese dhe detyrime përmbledhëse midis formimit teorik dhe praktik duke mundësuar arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim. Në këtë program studimi nuk kemi për momentin transferime apo mobilitete të studentëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi II.5

Institucioni i arsimit të lartë nxit përfshirjen e studentëve dhe partnerëve, rrjeteve dhe organizmave të tjera në hartimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të programit të studimit dhe realizimin me sukses në përputhje me objektivat e tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Për përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës, gjatë hartimit dhe ecurisë së programit të studimit, njësitë përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e	Në takimet e zhvilluara u raportua se ky program studimi është hartuar në bazë të nevojave të tregut të punës si dhe është i ngjashëm në nivele të larta me programe të njëjta të cilat ofrohen brenda dhe jashtë Shqipërisë. Paralelisht, ata raportuan se do të krijohet edhe në këtë program studimi (si në programet aktuale) një database me të gjithë të diplomuarit me qëllim mbajtjen e kontakteve.

institucioneve partnere, të diplomuarve, dhe aktorëve të tjerë nga tregu i punës.	GVJ konsideron si të rëndësishme rishikimin dhe riorganizimin deri në 20% të planit mësimor të këtij programi studimi dhe beson se IAL-ja duhet të punoj më fort drejt këtij drejtimi për këtë program studimi.			
Kriteri 2. Institucioni nxit dhe përfshin në diskutime studentët dhe strukturat e tyre, mban kontakte dhe konsultohet vazhdimisht me studentët e diplomuar, për përmirësimin e programit të studimit, dhe reflektimin kur ato janë në ndihmë të përmirësimit të programit të studimit.	Institucioni nxit dhe përfshin studentët në strukturat e veta. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik si dhe marrin pjesë në komisione të ndryshme të ngritura në procese të ndryshme. Gjatë takimit me studentët ata raportuan përfshirje në takime/diskutime të ndryshme si dhe pohuan se pedagogët marrin mendimin e tyre për çështje të ndryshme. Konsultimi me studentët e diplomuar nuk është ende i mundur pasi institucioni nuk ka një database të studentëve të diplomuar ku të mbaj kontakte me ta. Drejtuesit e njësive Kryesore dhe Bazë raportuan dëshirën dhe vullnetin e tyre për të mbajtur kontakte të vazhdueshme me të diplomuarit në kuadër të përmirësimit të programit të studimit. Ref. H.2 Miratimin për ngritjen e grupit të vlerësimit të brendshëm GVB; Ref. 6.1. Vendim Senati Akademik “Krijimi i Zyrës së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë”. 23.10.2010;			
Kriteri 3. Njësia përgjegjëse përmirëson, përditëson, përshtat programin e studimit në përputhje me propozimet dhe zhvillimet e fundit në fusha të ndryshme në bashkëpunim me rrjete profesionistësh, shoqata, urdhra profesionale (veçanërisht në fushën e mjekësisë) dhe institucione publike e private.	Institucioni raportoi se do të ketë bashkëpunime të ngushta me rrjete profesionistësh dhe në bazë të zhvillimeve të fushës së fizioterapisë do të përshtasë dhe përditësoj programin e studimit Bachelor në “Fizioterapi”.			
Konkluzione	Institucioni nxit dhe përfshin studentët në strukturat e veta. Studentët janë pjesë e Senatit Akademik si dhe marrin pjesë në komisione të ndryshme të ngritura në procese të ndryshme. GVJ mendon se ky standard përmbushet plotësisht.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel: +355 (04) 222-43423

E-mail: info@ascal.al

Web site: www.ascal.al

Standardi III.1

Institucioni i arsimit të lartë garanton procesin e të nxënit, aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira me në qendër studentin, që sigurojnë arritjen e rezultateve.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike, detyrat e kursit/esetë, projektet, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.	Neni 41 i Rregullores së Albanian University përcakton qartë format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive tëk studentët. Sipas këtij neni, veprimtaritë formuese, që karakterizojnë këtë program studimi, përbëhen nga përberesit mësimore të cilët ndahen në: 1. Mesim në auditor, si leksione, seminare, ushtrime, ushtrime fizike në terrene sportive, laboratore, forma të kontrollit të vazhdueshëm dhe seanca të praktikave profesionale, të zhvilluara në auditor; 2. Studim individual, si studim e punim relacionesh, detyrash apo projektsh; 3. Përgatitje për provime; 4. Përgatitje e tezës së diplomës; 5. Veprimtari të tjera, si praktika profesionale, praklika në terren apo stazh pranë subjekteve publike ose private. Ndarja e oreve mësimore në auditor ne orë për leksione, seminare, ushtrime e laboratore, përcaktohen në planin mësimor të programit të studimit. Neni 7 i rregullores së programit të studimeve përcakton po ashtu veprimtaritë formuese të programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”. Paralelisht, AU organizon rregullisht orë të hapura për rritjen e njohurive dhe aftësive të stafit akademik edhe studentëve. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 7; Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 41; Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor Bsc, në “Fizioterapi”; Ref. 3.12. Tabela e Leksioneve të hapura 2019-2024;
Kriteri 2. Personeli akademik respekton dhe u përgjigjet larmisë dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies.	Institucioni referon se, personeli akademik respekton diversitetin e nevojave të studentëve duke operuar me forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies me qëllim gjithëpërfshirjen. Studentët kanë mundësi të marrin pjesë në konsultime që organizohen nga personeli akademik për të përvetësuar konceptet themelore të lëndëve. Personeli akademik mundohet ti përgjigjet nevojave të studentëve duke u ofruar mënyra e metoda alternative të mësimdhënies. Pedagogët raportuan se leksionet i zhvillojnë duke përdorur mjete teknologjike (poëer point prezantime, videoprojektor, etj), ndërsa një pjesë të leksioneve i dërgon të detajuara edhe në forma alternative si word/pdf etj. ;
Kriteri 3. Institucioni mbështet personelin akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike dhe në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit.	Në vizitën në institucion të GVJ, Institucioni referon se mbështet dhe ofron mundësinë e mobilitetit të personelit akademik dhe ndihmës akademikë pranë universiteteve partnere, për përmirësimin e kompetencave didaktike. Në universitetet partnere, pedagogët kanë mundësi të trajnohen si dhe të zhvillojnë leksione. Pedagogë të departamentit kishin kryer vizita dhe mobilitete jashtë Shqipërisë.

	Albanian University po ashtu organizon rregullisht ëorkshope dhe leksione të hapura të cilat u japin mundësinë pedagogëve të rrisin aftësitë e tyre didaktike. Institucioni nuk ka ndonjë plan specifik edhe/ose udhëzues për përmirësimin e kompetencave didaktike të personelit dhe GVJ sugjeron se hartimi i një plani të tillë do ishte pozitiv. Ref. 3.12. Tabela e Leksioneve të hapura;
Kriteri 4. Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënien në program është kompetent në shpjegimin e njohurive dhe koncepteve, përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies interaktive dhe diskutime me në qendër studentin, nxit te student mendimin krijues, atë kritik si dhe autonominë e përgjegjshmërinë Në të njëjtën kohë siguron udhëheqjen, mbështetjen dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Instituciononi referon se, ka të përcaktuara kriteret e detajuara për rekrutimet e personelit të angazhuar në mesimdhënien akademike si atë me kohë të plotë, por dhe atë me kohë të pjesshme, ku në takimin e zhvilluar me përfaqësues së Burimeve Njerëzore u raportua e gjithë procedura. Përsa i përket personelit akademik të angazhuar në mësimdhënie nëse është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit, në vizitën që u bë në Institucion pedagogët referuan që mundoheshin ta zhvillonin leksionin në mënyrë interaktive me diskutime me referime të ndryshme. Paralelisht, studentët vlersojnë stafin dhe programin e studimeve përmes pyetësorit që zhvillohet. Studentët raportuan se gjatë leksioneve ata marrin pjesë në mënyrë aktive ndërsa pedagogët i përfshin në diskutime për çështje të lëndës. Ref. 6.7. Pyetësorët e studentëve, stafit akademik dhe administrative v.a. 2019-2020. Ref. 1.1.b. Statuti i “Albanian University” I miratuar në korrik 2023, neni për rekrutimin e personelit akademik PAE dhe PAK.
Kriteri 5. Njësia përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e këshillat e tyre.	AU organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve. Në bazë të këtij aktiviteti merren masa të cilat pasqyrohen në raportin vjetor. Paralelisht, Drejtuesi i Njesisë Bazë përmes një instrumenti standard vlerëson pedagogët që japin leksion në këtë program studimi. Pavarësisht këtyre, nuk u përmendën aktivitete specifike të tjerë për përmirësimin e mësimdhënies. Ref. 3.5. Model Pyetësori për studentat për programin e studimit. Ref. 6.7. Pyetësorët e studentëve, stafit akademik dhe administrative v.a. 2019-2020. Ref. 6.7. b. Pyetësorët e studentëve v.a. 2020-2021; Ref. 6.7. c. Pyetësorët e studentëve v.a. 2021-2022; Ref. 6.7. d. Pyetësorët e studentëve v.a. 2022-2023; Ref. 6.10. Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilesisë;
Kriteri 6. Institucioni organizon struktura/ njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e	Institucioni referon se, ka në përbërje të tij struktura akademike dhe ndihmës akademike me qëllim funksione të ndryshme përfshirë këtu kurrikulat, alumni, projektet, cilësinë etj. Në takimet e zhvilluara këto struktura nuk raportuan aktivitete specifike për përmirësimin e

vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies. Strukturat dhe njësitë përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies, trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe zbatimit të metodave të reja.	vazhdueshëm të mësimdhënies. Përfaqësuesit e Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë raportuan zhvillimin e pyetësorit si një nga aktivitetet kryesore për përmirësimin e mësimdhënies Njësia Bazë përmes drejtuesit të departamentit mbështet përdorimin e metodave inovative, ndjek zhvillimin e orëve të mësimin nga pedagogët si dhe inkurajon studentët të raportojnë problematika të mundshme. Angazhimi më i madh i strukturave ndihmësakademike është i nevojshëm në përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies. Ref. 6.4. Strategjia për Sigurimin e Cilësisë në “Albanian University”; Ref. 6.10. Rregullore Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë;			
Konkluzione	<i>Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, punët laboratorike etj. Ndërsa pedagogët përdorin metoda alternative e inovative për mësimdhënien. Institucioni mbështet stafin akademik për përmirësimin e aftësive didaktike. Hartimi i një plani specifik për këtë është e nevojshme sipas GVJ. Në kuadër të përmirësimit të mësimdhënies, AU organizon periodikisht pyetësorin e studentëve me qëllim vlerësimin e pedagogëve.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Standardi III.2 Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.				
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve			
Kriteri 1. Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale përcaktohen në Rregulloren e programit të studimit/Rregulloren e Institucionit/rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.	Institucioni në rregulloren e vet ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Neni 52 i Rregullores së Institucionit paraqet qartë këtë ku thuhet se kontrolli i dijeve realizohet nëpërmjet testeve, testeve me shkrim e me gojë, eseve, detyrave të kursit, punëve në grup, projekteve, prezantimeve, praktikave dhe tezave të diplomës. Kontrolli i dijeve shërben për vlerësimin e progresit të studentit dhe mat përvetësimin e objektivave formuese e të kompetencave profesionale të programit nga studenti. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijes së një lende, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimit të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësim-përme: me shkrim, me gojë, me projekt.			

	Ref.2.1. Rregullorja e Programit te Studimit, Bsc në Fizioterapi, neni 19; Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52;"Rregullore e Provimeve".
Kriteri 2. Në fillim të çdo lënde/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Gjatë vizitës në institucion, në takimin me pedagogët, ata referuan se, në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulit në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format, informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit. Studentët po ashtu njihen me mënyrën e vlerësimit të dijeve, së bashku me afatet kur duhet të plotësohet secili detyrim deri në përfundim të zhvillimit të lëndës. ;
Kriteri 3. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.	Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara. Provimet zhvillohen me shkrim dhe në varësi të specifikave të lëndës, provimi mund të jetë dhe me gojë ose i kombinuar. Paralelisht, pedagogët në disa raste raportuan se gjatë zhvillimit të lëndës vlerësojnë studentët dhe performanca e tyre merret parasysh në notën përfundimtare të studentit. Po ashtu, disa pedagogë raportuan se u japin studentëve detyra kursi (individuale ose në grup) mbi të cilat ata vlerësohen. Ref. 2.11. Model Syllabusi; Ref. 2.6. Syllabuset e Lëndëve.;
Kriteri 4. Njësia bazë/Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	AU ka në përbërjen e vet Njësinë e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ajo realizon periodikisht vlerësimin e pedagogëve nga studentët. Në përfundim të lëndëve studentët vlerësojnë pedagogun e lëndës duke dhënë rekomandimet respective. U raportua se në bazë të rezultateve njësitë respective mundohen të zgjidhin problematikat e ndryshme. <u>Nuk u raportua hartimi i një plan veprimi specifik mbi rezultatet e këtyre metodave të vlerësimit.</u> Ref. 2.1. Rregullorja e Programit te Studimit, neni 19; Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52;
Kriteri 5. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve. Format dhe metodat e	AU inkurajon përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike. Këto metoda të ndryshme i japin mundësinë studentëve të rrisin njohuritë dhe aftësitë e tyre. Organizimi i leksioneve të hapura si dhe mobilitetet Erasmus i japin mundësinë stafit akademik të përmirësojë aftësitë akademike dhe didaktike si dhe ndërtimin e marrdhënieve të respektit dhe mbështetjes së studentëve. Paralelisht, studentët kanë mbështetjen e pedagogëve të tyre në raste se ata kanë pyetje apo paqartësi.

mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë të studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	Ref. 3.12. Leksioneve të hapura;			
Konkluzione	<i>Institucioni në rregulloren e vet ka përcaktuar qartë kriteret dhe mënyrën e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale. Në fillim të çdo semestri studentët njihen me syllabusin e lëndës, modulën në të cilin përcaktohen në mënyrë të detajuar mënyra e kontrollit dhe format. Testimi i vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.3

Institucioni siguron vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti duke përfshirë dhe procesin e ankimimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik dhe reflektohet në vlerësimin përfundimtar, të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.	Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijes së një lënde, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimit të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësipërme: me shkrim, me gojë, me projekt. Në vizitën në Institucion GJV mori informacion në lidhje me vlerësimin e njohurive të studentëve. Ata referuan se provimi përfundimtar ishte mënyra e vlerësimit të studentit. Ata referuan se ky provim kishte vlerësimin për performancën e studentit, provimi bëhet me shkrim por kishte pedagogë që preferonin provimin me gojë ose në mënyrë të kombinuar. Gjithashtu dhe detyrat e kursit ishin pjesë e vlerësimit përfundimtar të studentit. Syllabuset e pedagogëve prezantojnë qartë mënyrën se si do të zhvillohet testimi dhe vlerësimi i studentëve. Ref. 2.1 Rregullorja e Programit të Studimit Bsc në Fizioterapi neni 19; ;
Kriteri 2. Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit, të cilat shmangin forma të ndryshme	Institucioni përdor vetëm metoda tradicionale të testimit dhe vlerësimit dhe nuk ka filluar të përdorë sisteme elektronike korrigjimi të testeve. Në takimin me pedagogët ata pohuan se nuk përdorin ende sisteme korrigjimi elektronike.

abuzimi dhe rrisin transparencën.	<i>Implementimi i projektit CleanScore i financuar nga “Fondacion Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim, AADF” edhe në këtë program studimi është i nevojshëm.</i>
Kriteri 3. Vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin dhe bazën ligjore në fuqi.	Kontrolli përfundimtar i dijeve mund të zhvillohet me provim i cili mund të jetë testim fizik, test me shkrim; me gojë ose i kombinuar (me shkrim e gojë). Zgjedhja e formës së provimit bëhet nga pedagogu/et i lëndës, pasqyrohet në programin lëndor (syllabus) dhe në rregulloren e programit të studimit si dhe ju bëhet e ditur studentëve që në fillim të semestrit. Vlerësimi i njohurive të studentit bëhet duke përdorur sistemin shqiptar të vlerësimit me 10- të dhe shkronjat nga A deri në E, ku 10- ta dhe A-ja është vlerësimi maksimal. Me këtë sistem bëhet vlerësimi në të gjitha format e kontrollit të përdorura. Nota minimale kaluese është 5 (pesë). Institucioni referon që, vlerësimi përfundimtar i lëndës bëhet në përputhje me syllabusin si dhe sipas rregullores së AU-së, rregullores së Njesisë Kryesore dhe rregullores së programit të studimeve. Pedagogët referuan se vlerësimi i studentëve zhvillohet në bazë të legjislacionit në fuqi ndërsa studentët raportuan se ai zhvillohet në bazë të syllabusit dhe asaj çfarë pedagogu i ka informuar në orën e parë të leksionit. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, Bsc në Fizioterapi neni 19; Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52; Ref. 2.11. Model Syllabusi.
Kriteri 4. Vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback (nëse është i nevojshëm) dhe lidhet me këshilla mbi procesin e të nxënës për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.	Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 7 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentet informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë. Në rastet se studentët kanë paqartësi mbi vlerësimin e tyre, mund të konsultohen me pedagogun e lëndës. Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52.
Kriteri 5. Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin/nuk lejojnë plagjiaturën, kopjimin në provime dhe detyra.	Provimet dhe riprovimet në të gjitha ciklet e studimeve zhvillohen sipas afateve të caktuara në strukturën e vitit akademik. Komisioni i provimit të një lënde (moduli) përbehet nga jo më pak se dy vetë, nga të cilët njëri duhet të jetë pedagogu i lëndës (modulit). Nëse titullari i lëndës apo anëtar i tjetër, për arsye madhore, nuk mund të marrin pjesë në provim, përgjegjësi i departamentit cakton me shkrim pedagogun që do t'i zëvendësojë. Ndalohej hyrja në provim e personave të jashtëm, qofshin dhe anëtarë të stafit akademik të universitetit, me përjashtim të drejtuesit të Departamentit, të Njesisë Kryesore, anëtarëve të Rektoratit dhe personave të tjerë të autorizuar me shkrim nga dekani ose rektori për të kryer kontroll. Pedagogët referuan se nuk lejohet në asnjë moment kopjimi dhe komunikimi me student të tjerë si dhe në detyrat e kursit

	nuk lejojnë plagjiaturën. Studenti konsiderohet ngelës nëse kopjon ose mashtron me mjete ndihmëse jo të lejueshme (në këtë rast ai përjashtohet nga provimi). Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52;			
Kriteri 6. Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen në meritë dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.	Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 7 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentët vlerësohen në bazë të njohurive dhe aftësive të tyre të demonstruara në provim apo në praktikën e zhvilluar. Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52;			
Kriteri 7. Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregullat që përfshihen në statut, rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.	Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit në përfundim të provimit me gojë dhe për provimin me shkrim, brenda 7 ditëve pune nga data e zhvillimit të tij. Studentet informohen mbi rezultatet e provimit në librezën e tyre elektronike, por nëse nuk e kanë marrë këtë informacion për arsye të ndryshme, mund të informohen pranë sekretarisë. Sipas nenit 52 të Rregullores së AU-së, studenti ka të drejtë të ankohet në rast se ndaj tij janë shkelur rregullat proceduriale gjatë zhvillimit të provimit ose për vlerësim të pamërituar. Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 52;			
Kriteri 8. Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur duhet të jetë transparente për palët e përfshira, dokumentohet dhe arkivohet.	Nga vizita në institucion dhe nga materiali i vënë në dispozicion nga GVB-ja u vu re që brenda Rregulloreve të Përgjithshme të Institucionit, Rregulloreve të Programit të Studimit, si dhe Brenda Statutit nuk ekzistonte një nen mbi organizimin e një procedure në rast të ankesave për notën nga studentat. GVJ këshillon modifikimin ose riorganizimin e rregulloreve Brenda institucionit.			
Konkluzione	<i>Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet se kontrolli i dijes së një lënde, e cila realizohet gjatë sezonit të provimeve, mund të bëhet nëpërmjet: 1) Provimit me shkrim; 2) Provimit me gojë; 3) Vlerësimit të një projekti; 4) Kombinimit të formave të mësipërme. Institucioni përdor vetëm metoda tradicionale të testimit dhe vlerësimit së studentave. Pedagogu u bën me dije studentëve rezultatet e provimit brenda afateve të caktuara dhe mungojnë procedurat ku studentët kanë të drejtën të ankimojnë vlerësimin në rast se konsiderojnë të padrejtë.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.4

Adresa: "Rruga e Durrësit"
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 4 222-43423

Web site: www.asc.al

E-mail: info@asc.al

Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Programi i studimit duhet të garantojë thellimin e njohurive, të zhvillojë aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.	Programi i studimit Bachelor në “Fizioterapi” garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Ky program ka si objektiv të formojë profesionistë të pajisur me shprehitë bazë shkencore dhe praktike në fushën e fizioterapisë. Kursi i studimit të diplomës në "Fizioterapi", synon të formojë profesionistë që të jenë në gjendje të përballojnë futjen e metodave dhe teknologjive të reja e komplekse në fushën e fizioterapisë dhe ka për qëllim të formojë rehabilitues profesionistë me njohuri të thella për trupin e njeriut, për faktorët e ndryshëm që ndëmtimeve dhe procesin e parandalimit, rehabilitimit dhe përmirësimit të aftësive lëvizore të jetës së përditshme, rehabilitimit pas dëmtimeve apo traumave të ndryshme fizike si aksidenteve në punë e jashtë punës, dëmtimeve sportive; dhe rehabilitimin nga semundje të ndryshme kronike si rehabilitim kardiak për pacient me semundje kardiovaskulare, rehabilitim fizik për të gjitha llojet e dëmtimeve të aparatit muskuloskeletor, etj. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit Bsc në Fizioterapi;
Kriteri 2. Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane, sociale, komunikimit dhe ndërveprimit.	Programi i studimit u ofron mundësinë studentëve të marrin njohuri në fushën e statistikës dhe informatikës, ndërsa fusha të veçanta të karakterit human e sociale ku përfshihen lëndë si Psikologji, Psikopatologji mungojnë në planin mësimor. <i>GVJ konsideron si të rëndësishme rishikimin dhe riorganizimin deri në 20% të planit mësimor të këtij programi studimi dhe beson se IAL-ja duhet të punoj më fort drejt këtij drejtimi për këtë program studimi.</i> Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit Bsc në Fizioterapi;
Kriteri 3. Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të lëndës. Personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për zbatimin e tyre dhe për detyrimet përmbyllëse.	Pedagogët gjatë vizitës së GVJ, referojnë se, në fund të semestrit, pas mbarimit të lëndës pedagogu përveçse mundëson që studentët të arrijnë aftësitë, gjithashtu dhe të njohin çështjet më të rëndësishme të trajtuara gjatë semestrit, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e secilës lënde. Studentët mund të zhvillojnë pyetje të ndryshme ndërsa pedagogët zakonisht i orjentojnë duke diskutuar me ta pikat më të rëndësishme.
Kriteri 4. Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t’u japë	Studentët kanë mundësinë të aplikojnë njohuritë e marra në laboratore e praktika të cilat zhvillojnë gjatë studimeve të tyre. Pedagogët raportuan se ata inkurajojnë diskutimet dhe pjesëmarrjen aktive në klasë të

studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale. Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problemeve/çështjeve të caktuara; krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të përparuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet ato; ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundësuar dhe rritur mobilitetin e studentëve.	studentëve ndërsa studentët e pohuan këtë gjatë takimit të zhvilluar. Orët e seminareve zhvillohen në mënyrën e diskutimeve dhe punës në grup ku studentët mundohen të zgjidhin raste specifike të dhëna. Mobiliteti i studentëve është i mundur por deri në këtë moment nuk janë zhvilluar mobilitete. Pedagogët përmes pjesmarrjes së tyre në kërkime shkencore përmirsojnë njohuritë e tyre dhe mundohen të zhvillojnë studime të përparuara kërkimore. Ref.R.1. g- Lista e pjesëmarrësve në Konferencën Jubilare Prill 2024; Ref. 3.9 - Konferencat studentore DIF 2019 – 2024;			
Kriteri 5. Personeli akademik, efektiv dhe me kontratë, realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda/jashtë strukturës së programit të studimit.	Institucioni zhvillon orë të hapura rregullisht me akademik të spikatur brenda ose jashtë vendit. Këto takime u japin mundësinë stafit akademik por edhe studentëve të njihen me zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë brenda dhe jashtë strukturës së programit specifik të studimeve. Ref. 3.12. Leksione të hapura; ;			
Konkluzione	<i>Programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi" garanton thellimin e njohurive dhe aftësive profesionale të studentëve. Programi i studimit u ofron mundësinë studentëve të marrin njohuri në fushën e statistikës dhe informatikës ndërsa fusha të veçanta të karakterit human e sociale ku përfshihen lëndë si Psikologji, Psikopatologji mungojnë në planin mësimor. GVJ konsideron si të rëndësishme rishikimin dhe riorganizimin deri në 20% të planit mësimor të këtij programi studimi dhe beson se IAL-ja duhet të punoj më fort drejt këtij drejtimi për këtë program studimi. Orë të hapura organizohen rregullisht nga Institucioni me qëllim rritjen e njohurive dhe aftësive të studentëve. .</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi III.5

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton rregullore të posaçme për provimin i përgjithshëm përfundimtar ose punimin e diplomës. Në rregulloren e programit të studimit përcaktohet pragu i notës mesatare që i jep të drejtën studentit për punim diplome dhe e bën atë publike.	Sipas planit mësimor, për përfundimin e studimeve Bachelor në "Fizioterapi", studentët duhet të japin provimin përfundimtar ose me punim teme diplome. Ky provim ka 6 kredite. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi". Provimi realizohet përpara një komisioni të posaçëm, të përberë nga pedagogë efektiv dhe të ftuar, të fushave që mbulon programi i provimit. Anëtarët e komisionit propozohen nga njesitë bazë të cilët mbulojnë lëndët e përfshira në provimin e përgjithshëm, dhe miratohen nga drejtuesi i FSHM-së. Detaje mbi organizimin e provimit final prezantohen tek neni 29 i Rregullores së programit të studimit. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 26, neni 29; Ref. 2.2. Model, Plan Mësimor 2021-2022, Bachelor në "Fizioterapi"; Ref. 3.16. Model Teze Provimi; Ref. 3.17. Manual i punimit të Diplomës.
Kriteri 2. Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.	Njësia bazë përgjegjëse e programit të studimit organizon konsultime me studentët për tematika të ndryshme të programit të provimit sipas një grafiku të miratuar prej saj dhe të shpallur në mjediset publike. Paralelisht, studentët kanë mundësi të zhvillojnë pyetje dhe konsultime me pedagogët përkatës në bazë të nevojave që ata kanë. Po ashtu Njësia Bazë miraton dhe publikon lëndët dhe tematikat përkatëse të provimit të diplomimit në bachelor. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 26, neni 29; Ref. 3.16. Model Teze Provimi; Ref. 3.17. Manual i punimit të Diplomës.
Kriteri 3. Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë gjithë viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.	Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi". Teza e provimit përmban pyetje nga të gjitha fushat/lëndët që përfshihen në programin e provimit. Njësitë bazë të përfshira në provimin e përgjithshëm përfundimtar hartojnë fondin e pyetjeve dhe i depozitojnë në Departament të paktën një javë para fillimit të sezonit të provimit. Fondi i pyetjeve duhet të jetë rreth 10 herë më i madh se numri përkatës i pyetjeve që përmban teza në fushën përkatëse. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 26, neni 29; Ref. 3.16. Model Teze Provimi;
Kriteri 4. Personeli akademik/Udhëheqësi i diplomës	Ky program studimi parashikon hartimin e një teme diplome për përfundimin e studimeve. Në takimet e zhvilluara në AU, stafi

orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit të diplomës. Udhëheqësi asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe në punimin e diplomës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.	akademik pohoi se përfshin student në studime e kërkime shkencore të cilat ai realizon. Studentët përfshihen në procedura si mbledhje të dhënash, ose asistim në procese të ndryshme të kërkimit dhe studentët më të mirë të spikatur dhe me mesatare të lartë ftohen të bëjnë mbrojtjen e diplomës me temë. Kjo u konfirmua edhe nga studentët në takimin e zhvilluar me ta. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 26, neni 29; Ref. 3.17. Manual i punimit të Diplomës.
Kriteri 5. Njësia bazë asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.	Në takimet e zhvilluara në AU, stafi akademik pohoi se përfshin student në studime e kërkime shkencore të cilat ai realizon. Studentët përfshihen në procedura si matje dhe mbledhje të dhënash, ose asistim në procese të ndryshme të kërkimit. Kjo u konfirmua edhe nga studentët në takimin e zhvilluar me ta. ;
Kriteri 6. Në përfundim të provimit të përgjithshëm përfundimtar ose të mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.	Në përfundim të provimit të përgjithshëm studenti vlerësohet me notë. Nota është mesatarizim i vleresimit që ka dhënë çdo anëtar i komisionit. Kur studenti vlerësohet me notë pozitive, FSHM e pajis studentin e sapodiplomuar me diplomën "Bachelor në "Fizioterapi të shoqëruar me suplementin. Në rast se studenti vlerësohet me notë negative në provimin e përgjithshëm përfundimtar, ai mund të rihyjë në provim brenda një afati kohor të caktuar, por pa tejkaluar afatin maksimal të përcaktuar në komizën ligjore në fuqi. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 27;
Kriteri 7. Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.	Në përfundim të studimeve studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës të miratuara nga MAS. Në rregulloren e AU-së neni 55 përcaktohen qartë këto si dhe në rregulloren e Njesisë Kryesore neni 52. Ref. 2.1. Rregullorja e Programit të Studimit, neni 29; Ref. 1.3.b. Rregullorja e AU-së, neni 55; Ref. 3.19. Modeli i Diplomës. FSHM. Bachelor në "Fizioterapi"; Ref. 3.20. Suplementi i Diplomës. FSHM. Bachelor në "Fizioterapi";
Kriteri 8. Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen.	Kopje e dokumentacionit ruhet në Institucion sipas legjislacionit në fuqi. Gjatë vizitës në AU, GVJ u informua dhe verifikoj në terren të gjithë dokumentacionin e disponueshëm që sekretaria mësimore kishte. ;

Konkluzione	<i>Për përfundimin e studimeve Bachelor në "Fizioterapi", studentët duhet të japin provimin përfundimtar ose punimin e një Teme. Ky provim ka 6 kredite. Programi i provimit të përgjithshëm përfundimtar përfshin lëndë të ndryshme nga fushat kryesore që mbulon programi i studimit Bachelor në "Fizioterapi". Procedura e organizimit të provimit është e pasqyruar në dokumentacionin e Institucionit.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

Standardi IV.1	
Personeli akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Personeli akademik efektiv dhe me kontratë, personeli ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbush kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e duhur të kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve mësimore të programit. Ka fushë kërkimore në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij.	GVJ, bazuar në RVB, evidencat, vizita në institucion, konstatoi se Personeli akademik efektiv, i angazhuar në realizimin e programit të studimit, të Ciklit të Parë, Bachelor në "Fizioterapi", ofruar nga Universiteti Privat "Albanian University", janë me grada dhe tituj shkencor duke përmbushur plotësisht kërkesat ligjore në fuqi. Pedagogët e angazhuar në këtë program studimi, shumica janë të kategorisë me Msc. GVB nga shyrtimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion, për realizimin e programit në departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë, janë angazhuar staf akademik për 5 vite akademike sipas Evidenca. 5. Tabelat përmbledhëse. Tabela Nr.1,1¹; 12¹ 13¹ 14¹ 15¹ Numri I personelit akademik (PAE; PAK; Staf ndihmës akademik) të angazhuar në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë., me si më poshtë: 1. Për vitin akademik 2020 - 2021 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 107 pedagogë nga të cilët 48 PAE dhe 59 PAK dhe 13 staf ndihmes akademik (45% / 55 %): 2.Për vitin akademik 2021 - 2022 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 85 pedagogë nga të cilët 42 PAE dhe 43 PAK dhe 14 staf ndihmes akademik (49% / 51 %);

3. Për vitin akademik 2022 - 2023 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 93 pedagogë nga të cilët 42 PAE dhe 51 PAK dhe 13 staf ndihmes akademik (45% /55 %);

4. Për vitin akademik 2023 - 2024 kanë dhënë mësim në këtë program studimi 91 pedagogë nga të cilët 55 PAE dhe 36 PAK dhe 15 staf ndihmes akademik (60% /40 %)

Stafi akademik i angazhuar në mësimdhënie në Programin Bachelor në Fizioterapi sipas gradave në vite nga 2020-2024

Tituj/ grada	2021-2022		2022-2023		2023-2024	
	PAE	PAK	PAE	PAK	PAE	PAK
Prof.Dr.	3	0	1	0	1	0
Prof. Asoc.	0	3	0	4	0	5
Dr./PhD.	6	6	6	5	5	3
Msc.	16	4	16	4	14	3
Proces Dr.	0	1	1	1	2	1
Totali	25	14	24	14	22	12
Raporti PAE/PAK	25/14 64%/36%		24/14 63%/37%		22/12 66%/34%	

Nga sa më sipër rezulton se në procesin e mësimdhënies të programit të ciklit të Parë , Bachelor në "Fizioterapi", për të pesë vitet janë me Msc, Prof, Prof.Asoc, Dr, në përputhje me nenin 59/6 të Ligjit nr. 80/2015 ku përcaktohet: "Personeli akademik, që angazhohet në mësimdhënie, duhet të ketë së paku kualifikim të ciklit pasardhës", por vrehet se Raporti PAE/PAK nuk është 70% PAE/ 30% PAK

GVJ sygjeron përmirësimin e këtij raporti, duke I dhënë peshën kryesore të mësimdhënies PAE.

Ref. 1.3.a,b- Rregullore e Albanian University.
Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf
Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf
Ref.4.1 - Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2020 - 2024.pdf

Kriteri 2. Personeli akademik efektiv duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për

GVJ, bazuar në DVV dhe në takimin me drejtuesit e institucionit, konstatoi se, personeli akademik efektiv, i cili është i angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit, ka ngarkesë mësimore të përcaktuar në kontratën e punës me AU-ne si dhe, në përputhje me Vendim Nr. 41, Datë 24.1.2018"

programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi.

Për Elementet e Programeve të Studimit të Ofruara nga Institucionet e Arsimit të Lartë”. GVJ gjatë vëzhgimit të ngarkesës mësimore që mbulon stafi akademik vë re se kjo ngrakes është e shpërndar mirë sipas ligjit dhe udhëzimit nr 29 “Mbi ngarkesën mësimore në institucionete Arsimit të Lartë “ Nga shqyrtimi i dokumentacionit u konstatua se ngarkesa mësimore e personelit akademik për tre vite akademike është si më poshtë vijon:

Viti	Total orësh	PAE	PAK	PAE/PAK (%)
2023-2024/ sem 1	1594	1108	396	70% / 30 %
2023-2024 Sem 2	1428	1047	381	73%/27%
2022-2023 sem 1	1490	1054	436	71% / 29%
2022-2023 Sem 2	1418	1022	396	72% / 28%
2021-2022 Sem 1	1901	1383	518	78%-22%
2021-2022 Sem 2	1770	1261	509	71%/29%

Nga sa më sipër rezulton që për 3 vite akademike, ngarkesa mësimore për këtë program studimi, është përballuar me mbi 70% nga stafi akademik me kohë të plotë, sipas VKM Nr. 418, datë 10.05.2017 ku citohet: “Personeli akademik me kohë të plotë duhet të mbulojë jo më pak se 70% të ngarkesës mësimore për cdo program studimi”, në përputhje me fushën e kualifikimit dhe fushën kërkimore të anëtarëve të stafit.

Ref. 4.1 - Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2019 – 2024,

Ref. 1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf

Ref.1.4.a- Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022.pdf

Ref. 1.5 Rreg e Fakultetit te Shkencave Mjekesore (2).pdf

Kriteri 3. Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit,

GVJ, bazuar në takimin me drejtues të institucionit si dhe referencat e vëna në dispozicion, vuri re se, AU si një IAL jo publik, ka kontrata pune për të gjithë stafin akademik me kohë të plotë, që i përket kategorisë “Lektor” ose “Profesor” sipas ligjit të Arsimit të Lartë 80/2015. Personeli akademik efektiv i angazhuar në programin e studimit , të ciklit Ciklit të Parë , Bachelor

për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore.	në "Fizioterapi", gjatë 3 viteve të fundit nuk ka pësuar shumë ndryshime, pra ka patur qëndrueshmëri. Kjo vërehet në listën e PAE të tre viteve të fundit. GVJ në takimin me stafin e burimeve njerëzore <i>konstatoi se stafit akademik që nga dita e parë e lidhjes së kontratës së punës me AU-në, i garantohen mbulimi me sigurime shoqërore dhe shëndetësore, duke u deklaruar në organet përkatëse.</i> Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.a- Strategjia e Zhvillimit Institucional 2017-2022.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf Ref. 4.1. Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2019 - 2024.pdf
Kriteri 4. Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	GVJ, gjatë takimit me zyrën e burimeve njerëzore, takimin me shefin e departamentit, referencat e vëna në dispozicion vuri re se, AU ka politika dhe procedurë korrekte për rekrutimin e stafit akademik, të bazuar në rregulloren dhe Statutin e AU, në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Kodin e Procedurave Administrative, LAL të IAL Publike në 80/2015. Politikat dhe procedurat e rekrutimit të stafit akademik përcaktohen nga evidentimi i nevojave për personel të ri sipas programit të studimit, deri tek vlerësimi i performancës së personelit akademik. Procedura e rekrutimit bëhet me propozim nga departamenti sipas nevojave dhe me miratim nga Rektorati. Kriteret propozohen në varësi të vendit të lirë nga struktura përkatëse (Drejtuuesi i Departamentit). Kriteret (të përgjithshme dhe preferenciale) dhe dokumentat që duhen si dhe dead line shpallen publikisht, njoftimet bëhen në faqen zyrtare të universitetit, në rrjetet sociale dhe në APP dhe përzgjedhja bëhet me konkurs dhe për çdo vend vakant të shpallur. Pranimi i dokumentave bëhet vetëm me rrugë postare. GVJ sic konstatoi vëren se, institucioni ndjek procedura ligjore të rregullta dhe transparente të rekrutimit të personelit akademik sipas programit të studimit, mbështetur në kriteret dhe procedurën për punësimin e personelit akademik dhe ndihmës akademik dhe kjo e mbështetur në Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë, Statutin e Rregulloret e AU -së. Institucioni ka një strukturë të posaçme të emërtuar Zyra e Burimeve Njerëzore e cila ka krijuar një bazë të dhënash për personelin dhe vendet e lira të punës. Përzgjedhja e personelit bëhet, duke marrë në konsideratë mungesat në stafin e brendshëm (sipas kërkesës së departamentit), si dhe ngarkesën mësimore. Zyra e burimeve njerëzore të AU publikon në faqen zyrtare vendet vakant sipas kërkesave të departamentit, kriteret e përgjithshme dhe kriteret preferenciale si dhe dead-line. Kandidatët e interesuar dërgojnë në e-mailin e institucionit CV dhe Kërkesën e tyre. Institucioni formon një komision ad-hoc sipas statutit të AU (dekan, shef departamenti, një PAE, një anëtar nga zyra e burimeve njerëzore si dhe Zv.Rektori për anën mësimore) të cilët vlerësojnë dosjet e paraqitura dhe për shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur bëhet pikëzimi si dhe pas kësaj

	bëhet dhe intervista me gojë (kandidati paraqet një leksion në gjuhë të huaj, kryesisht anglisht). Komisioni bën tabelën përmbledhëse dhe përcakton fituesin dhe jo fituesin të cilin e sqaron për rezultatet e marra (me gojë ose me e-mail). Komisioni informacionin ja dërgon dekanatit dhe ky i fundit e përcjell në rektorat i cili kthen përgjigjen për lidhjen e kontratës dhe kostove financiare për kandidatin fitues. GVJ në inspektimin e dy dosjeve në mënyrë rastësore (PAE dhe PAK) konstatoi që dosjet ishin të plotësuara me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm si(ID,CV,diploma të noterizuara , lista notash të noterizuara, licensa, raporti mjeko-ligjor,librez pune, librez shëndeti, aktivitetet shkencore si dhe kontrata e punës e lidhur me institucionin). Ref.1.1, 1.1.a- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref. 1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.a,b- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b- Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf Ref.6.9 Pyetësi i personelit akademik mbi lumturinë në punë.pdf Ref.6.10 Rregullore NJSBC.pdf Ref.6.11 Kodi i Etikës.pdf								
Kriteri 5. Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.	GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, takimin me stafin akademik dhe ndihmës akademik si dhe referencat e vëna në dispozicion, konstatoi se, pranë çdo departamenti ka të angazhuar personel ndihmës akademik përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe ambienteve të tjera mësimore për programin e studimit të ciklit Ciklit të Parë, Bachelor në "Fizioterapi". Të drejtat dhe përgjegjësitë e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e AU. Personel ndihmës mësimor në bashkëpunim me pedagogët e lëndëve siguron mirëmbajtjen e kabineteve për kryerjen e laboratorëve, praktikave mësimore dhe bën grafik sipas orareve mësimore që të mos ketë mbivendosje të studentëve në të njëjtën orë. Performanca e tyre matet edhe me anë të pyetësorëve anonim që bëhen dy herë në vitë, para sezonit të çdo semestri, si dhe performancës vjetore që bëhet nga shefi i Departamentit. Të dhënat e personelit ndihmës akademik sipas viteve akademike janë si më poshtë vijon: <table border="1"> <tr> <th>Viti Akademik</th><th>Asistente klinike(laborante) në departamentin e Infermierisë dhe fizioterapisë (total /fizioterapi)</th></tr> <tr> <td>2021-2022</td><td>T 14/ 1</td></tr> <tr> <td>2022-2023</td><td>T 13/ 1</td></tr> <tr> <td>2023-2024</td><td>T 15/1</td></tr> </table> Ref.Tabelat përmbledhëse, Tabela Nr.1,¹¹ ; ¹²; ¹³; ¹⁴; ¹⁵ Numri I personelit akademik (PAE;PAK;Staf ndihmës akademik) të angazhuar në Departamentin e Infermierisë dhe Fizioterapisë	Viti Akademik	Asistente klinike(laborante) në departamentin e Infermierisë dhe fizioterapisë (total /fizioterapi)	2021-2022	T 14/ 1	2022-2023	T 13/ 1	2023-2024	T 15/1
Viti Akademik	Asistente klinike(laborante) në departamentin e Infermierisë dhe fizioterapisë (total /fizioterapi)								
2021-2022	T 14/ 1								
2022-2023	T 13/ 1								
2023-2024	T 15/1								

Kriteri 6. Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtarit në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmës dhe administrativ.	GVJ në takimin me drejtues të institucionit, zyrën e burimeve njerëzore, dokumentacionin e vënë në dispozicion, u konstatua se Zyra e Burimeve Njerëzore (ZBNJ) është njësi e ngarkuar me përgjegjësi direkte për ruajtjen e dosjeve personale apo dokumentacionin e të gjithë personelit akademik dhe ndihmës akademik, të angazhuar në programin e studimit të ciklit të Parë , Bachelor në "Fizioterapi", Zyra e BNJ ruan dhe administron një informacion të hollësishëm për personelin. GVJ -së ju vunë në dispozicion nga Zyra e BNJ, të dhënat të depozituara në formë të printuar (dosje fizike të personelit akademik dhe ndihmës akademik me kërkesë të GVJ-së) si dhe një pjesë e tyre dhe në formë elektronike. Pranë Zyrës së Burimeve Njerëzore gjendet i gjithë dokumentacioni në lidhje me stafin akademik, atij ndihmës akademik dhe administrativ. Pranë zyrës së burimeve njerëzore ruhen dosjet e PE, të cilat përditësohen çdo fund viti me aktivitetin shkencor dhe CV e vitit përkatës. Njësia bazë dhe kryesore mban evidencë për realizimin e ngarkesës mësimore të stafit akademik për secilin semestër dhe vit akademik, qoftë të printuar por edhe në formë elektronike, si dhe ngarkesën , performancën e personelit ndihmës akademik dhe administrativ. Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.4.1. Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2019 - 2024.pdf Ref.6.9 Pyetësi i personelit akademik mbi lumturinë në punë.pdf Ref .6.10 Rregullore NJSBC.pdf Ref.6.11 Kodi i Etikës.pdf Ref.6.3.b,c,d,e,f - Pedagogët përgjegjës për sigurimin e cilësisë 2019-2020.pdf Ref.6.4 Strategjia për Sigurimin e Cilësisë 2022 - 2025.pdf Ref.4.2 - Kontrata individuale për pedagoget e jashtëm PAK.pdf Ref.4.3 - Kontrata individuale për pedagoget efektiv PAE.pdf Ref.4.4 - Kontratë individuale për stafin ndihmës akademik.pdf Ref.4.6 - Cv të stafit akademik.pdf Ref. R.1 Procedurë rekrutimi stafi akademik.pdf
Kriteri 7. Institucioni, në marrëveshje e bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e	GVJ, bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion si dhe takimit me drejtues të institucionit, stafin pedagogjik vuri re se, AU ka disa marrëveshje bashkëpunimi me institucione të arsimit të lartë që operojnë në fusha të njëjta apo të ngjashme me AU, si marrëveshje bashkëpunimi me SUT, me Shoqatën për integrim të pensionistëve të Shqipërisë, me FSHMT, Fizioprof Studiomed, Oda e Fizioterapistëve të Kosovës, Klinika Orthomed Sport, Klinika Physio. Fix, Spitali Memorial Fier, Spitalin Shefqet Ndroqi etj. Gjithashtu GVJ, konstaton se, AU ka në dispozicion personel të mjaftueshëm e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas programit të studimit, të Ciklit të parë Bachelo "Fizioterapi, sipas VKM 418, 10-05-2017, çdo pedagog ka në mbikëqyrje jo më shumë se 20 studentë.

studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b. Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.4.1. Ngarkesa mësimore e stafit akademik 2019 - 2024.pdf Ref.4.2 - Kontrata individuale për pedagoget e jashtëm PAK.pdf Ref.4.3 - Kontrata individuale për pedagoget efektiv PAE.pdf Ref.4.4 - Kontratë individuale për stafin ndihmës akademik.pdf Ref.4.6 - Cv të stafit akademik.pdf Ref.1.11 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf Ref.1.12 - Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf			
Kriter 8. Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale.	GVJ, gjatë takimit me studentët e programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” konstaton se, studentët në përmbushje të detyrimit të kryerjes së praktikës profesionale, mbikqyrën nga një përfaqësues i institucionit, ku ata kryejnë këtë praktikë, mbi bazën e marrëveshjeve specifike që AU, ka me këto institucione, gjë e cila u pohua edhe gjatë takimit me studentët e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”, të cilët u shprehën të kënaqur me këtë praktikë pune të ndjekur nga AU-ja. GVJ, bazuar në RVB dhe vizitën në institucion, vuri re gjithashtu se, personeli mbikqyrës në ambientin pritës, për realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, është ndihmues ndaj studentëve, në përmbushjen e detyrimeve dhe raportin përfundimtar të praktikës, si dhe në marrjen pjesë në procesin e vlerësimit të tyre, për praktikën profesionale. Studenti vlerësohet me notë para një komisioni të ngritur nga drejtuesi i departamentit dhe vlerësimi bëhet bazuar në performancën e praktikës të sjellë nga mbikqyrësi i praktikave studentore si dhe provimi me gojë (tema praktike) para komisionit. Ref.1.11 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf Ref.1.12 - Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf			
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard “Përmbushet Plotësisht” pasi ka personelin akademik që mbulon programin e studimit të ciklit Parë Bachelor në “Fizioterapi”, me grada dhe tituj sipas ligjit të arsimit të lartë të cilat përmbushin standardet cilësore, në përputhje me fushën e programit për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht

				X
--	--	--	--	---

Standardi IV.2

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse.	GVJ gjatë vizitës në institucion, vëzhgimit të ambienteve mësimore, salla leksionesh (1), sallë seminaresh (5), salla promovimi (2), laboratore (1), salla për praktika mësimore (1), biblioteka (1), fotokopje (7+1), mjedise për qeverinë studentore (1), sallë për IT (1), salla për aktivitete studentore (2), nyje hidrosanitare (9) vuri re se, AU ka hapësirat e nevojshme për zhvillimin sa më bashkëkohor të programit mësimor, azuar në numrin e studentëve si dhe infrastrukturën e këtyre ambienteve. Hapësirat mësimore janë pajisur me pajisjet e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboratorëve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve me Power Point. AU ka gjithashtu në dispozicion salla të kapaciteteve të ndryshme, duke akomoduar studentët sipas llojit të veprimtarisë dhe në përputhje me normativat në fuqi, si dhe me natyrën specifike të programit të studimit të Ciklit të Parë bachelor në “Fizioterapi” Ref.5. Tabelat përmbledhëse .Tabela 16 Mjediset e fakultetit , Njësia Bazë Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf Ref.4.11 - Faqja ëeb e Universitetit.pdf
Kriteri 2. Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.	GVJ, bazuar në vëzhgimin që u realizua në AU, si dhe referencat e vëna në dispozicion konstatoi se, AU ka aktualisht në përdorim laboratorë mësimorë dhe auditorë të pajisur me mjete audio vizive si PC, projektorë dhe foni në rastin e sallave të leksionit. Laboratori i informatikës që është një sallë me sipërfaqe 55 m², është e pajisur me softëaret përkatës në mënyrë që t'i shërbejnë sa më mire studentëve dhe stafit akademik të programit mësimor të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”. GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit u informua se AU ka investuar në mënyrë të vazhdueshme për përmirësimin e infrastrukturës së IT, e cila ndihmon stafin dhe studentët në procesin mësimor. Gjithë kjo infrastrukturë është realizuar edhe në vazhdimësi falë dhe rikonstruksionit përgjatë viteve në bazë të specifikave të programeve të studimit që ofron, i cili garanton infrastrukturën e nevojshme dhe cilësore për procesin e mësimdhënies. AU për të rritur transparencën ndaj studentëve, privatësinë, kontrollin në zbatimin e syllabuseve, kohës

	mësimore, informacioneve të detajuara për studentin nga dita e regjistrimit në AU deri në diplomimin e tij, bazuar dhe në urdhëresat e MAS përdor Sistemin PITAGORA. AU në të gjitha hapësirat e veta mbulohet nga sistemi i wireless, për të gjithë studentët dhe stafin akademik. Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.11 - Faqja web e Universitetit.pdf
Kriteri 3. Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.	GVJ, sic është shprehur edhe në kriterin 1,2, bazuar në vizitën në institucion dhe referencat e vëna në dispozicion konstaton se, AU ka infrastrukturën dhe pajisjen me aparaturat përkatëse për zhvillimin sa më korrekt të mësimin në Programin Bachelor në “Fizioterapi”. Mësimi zhvillohet në laboratorët, të cilët janë të pajisur me aparatura, instrumenta bashkëkohore. Gjithashtu lëndët teorike zhvillohen në salla të pajisura me mjete audio vizive si PC, projektore, foni dhe internet. Mirëmbajtja dhe azhurnimi i këtyre pajisjeve bëhet nga stafi i IT-së. Gjithashtu, programet kompjuterike në laboratorët e përshkruar më sipër i janë përshtatur programeve mësimore, duke instaluar programet aplikative, që kërkohen nga departamentet përkatës mësimorë. Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rregullore e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe refencës: Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf ; Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf në AU, vuri re se në godinën kryesore ndodhet një laborator i informatikës me sipërfaqe 55 m², i cili është i pajisur me PC internet dhe softëaret e nevojshëm për kërkimin shkencor në shërbim të studentëve dhe stafit akademik, sic është SPSS, të pajisur me programe profesionale, sipas natyrës së programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”. Pajisjet e tjera kompjuterike dhe laboratorët, janë të pajisur me softëare të dedikuar kërkimit shkencor dhe procesit akademik në fushën e sportit dhe trajnimit. Ref.1.11 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf Ref.1.12 - Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf



	Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.11 - Faqja eeb e Universitetit.pdf			
Kriteri 5. Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera (vërtetuar nëpërmjet marrëveshjeve të posaçme të bashkëpunimit), që mjediset janë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike. Në rastet e programeve të studimit në fushën mjekësore, institucioni duhet të sigurojë strukturat spitalore dhe ambulatorie me kapacitetet e nevojshme.	GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion si dhe takimin me drejtues të institucionit mendon se AU, garanton jo vetëm infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e procesit mësimor dhe veprimtarive praktike, jo vetëm në institucion por edhe duke bashkëpunuar me institucione publike dhe jo publike, organizata kombëtare dhe ndërkombëtare të tjera në funksion të praktikave profesionale të studentëve. GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit u informua se AU ka marrëveshje bashkëpunimi referuar: Ref.1.11 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf; Ref.1.12 - Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf (<i>Marrëveshjet e bashkëpunimit të AU me institucione të ndryshme</i>), me institucione të arsimit të lartë, që operojnë në fusha të njëjta apo të ngjashme me AU. AU bashkëpunon në përshtatje me natyrën e programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” Ref.1.11 - Lista e marrëveshjeve të bashkëpunimit.pdf Ref.1.12 - Raport analitik i përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit.pdf Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdf Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf			
Konkluzione	GVJ shprehet se ky standard “Përbushet plotësisht” , pasi IAL vë në dispozicion të studentëve, mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të programit të studimit të Ciklit të parë Bachelor në “Fizioterapi”			
Shkalla e përbushjes së standardit	Nuk përbushet	Përbushet pjesërisht	Përbushet kryesisht	Përbushet plotësisht
				X

Standardi IV.3

Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies, (bibliotekën, mjedise të posaçme).

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
----------	------------------------

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. “Q. Stafa”, Tiranë
Tel:+355 (0) 222-43 423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

Kriteri 1. Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit.	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, vizitën në institucion, takimin me stafin dhe studentët u informua se: ka një ambient të dedikuar për bibliotekën me një sipërfaqe 72 m² (Ref. 5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/ njësia bazë) Studentët kanë në dispozicion një gamë të gjerë tekstesh dhe literaturë shtesë të cilat përditësohen vazhdimisht. Pedagogët cdo vit përditësojnë ciklin e leksioneve dhe e depozitojnë atë në Departamentin përkatës. AU ka akses edhe në disa biblioteka online si: EBSCO; ERIC; Cambrig Journal. Studentët dhe stafi akademik mund të lexojnë dhe të shkarkojnë shumë libra qoftë për literaturën bazë, po ashtu dhe për literaturën e rekomanduar, sipas syllabuseve të lëndëve, programeve të lëndëve. AU ka një numër të madh librash dhe literaturë të pasur si në format të printuar por edhe në formë elektronike rreth 66 libra mjekësore me 3200 kopje. Librat janë kryesisht në dy gjuhë, anglisht dhe shqip, janë të grupuara sipas tematikave dhe programeve të studimit. Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/ njësia bazë Ref. 4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf Ref.4.11 - Faqja ëeb e Universitetit.pdf
Kriteri 2. Njësia përgjegjëse duhet të raportojë përditësime të literaturës me botime të viteve të fundit.	Gjatë takimit me stafin akademik GVJ konstatoi, se për çdo program lënde përditësojnë literaturën me botime të viteve të fundit. Në fund të çdo syllabusi të programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” ka rubrikën e literaturës bazë dhe literaturës së rekomanduar dhe stafi akademik çdo fillim viti akademik sipas lëndëve përkatëse duke përditësuar temat e lexioneve përditëson dhe literaturën përkatëse bazë dhe të rekomanduar. Pedagogu bën kërkesën në mbledhjen e departamentit për literaturën e përditësuar, këto kërkesa përcillen në njësinë kryesore dhe planifikohen në planin vjetor të përditësimit të bibliotekës. GVJ konstaton se AU, çdo vit në plan buxhetin e institucionit planifikohet edhe fondi për pasurimin e bibliotekës me libra dhe literaturë të 10 viteve të fundit. Ref.2.2 Plan program.pdf; Ref.2.3 - Kurrikula e peogramit të studimit.pdf; Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.16 mjediset e fakultetit/ njësia bazë Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf Vizita në institucion
Kriteri 3. Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të	GVJ konstatoi se, AU ka një bibliotekë universitare, e cila ka mjedise të mjaftueshme, një hapësirë 55 m² që ju shërben studentëve të <i>programit</i> të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” dhe mund të shfrytëzohet lirisht nga studentët që ndjekin këtë program studimi dhe kanë mundësi të konsultojnë apo shkarkojnë libra sipas literaturës bazë



barabartë nga studentët e programit të studimit.	apo të rekomanduar, sipas orareve të funksionimit të këtij institucioni. Biblioteka ofron hapësira të dedikuara për studentët për leximin si dhe një fond të pasur të librave universitarë. GVJ sic është shprehur dhe më lartë, mbi <i>Funksioni i Bibliotekës.pdf</i>, konstaton se biblioteka e AU zotëron gjithsej 15 libra mjekësor, në shqip dhe 45 libra në gjuhë të huaj si dhe vë në dispozicion të studentëve pa pagesë free linkun për shfrytëzimin e bibliotekës on line. Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf Vizita në institucion
Kriteri 4. Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.	GVJ gjatë takimeve në institucion konstatoi se AU ka vënë në dispozicion përdorimin e librave elektronike ku studentët mund të konsultohen me material ndërkombëtar sipas manualit të përdorimit elektronik të bibliotekës. Biblioteka e Universitetit është e pasur me tekste universitare, libra e revista shkencore në gjuhën shqipe dhe në gjuhë të huaj, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore të parashikuara për studentët e programit. Sipas referencës Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Biblioteka e AU furnizohet dhe planifikon vazhdimisht fonde për libra fizik dhe botime periodike si psh revista OPTIME.pdf që në bibliotekën e AU nuk mungojnë. GVJ në takimin me studentët u informua se studentët kanë të gjithë akses në bibliotekë fizikisht dhe on line edhe sipas Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Studentët dhe stafi akademik në mënyrë periodike shrytëzojnë literaturën fizikisht në bibliotekë, e cila pasurohet vit pas viti. Gjithashtu kanë akses në librarinë elektronike me anë të EBSCO; ERIC; Cambrig Journal Biblioteka e institucionit zotëron edhe katalogun e librave elektronik i cili lehtëson gjetjen e literaturës në gjuhë të huaj që janë me shumicë. GVJ gjatë vizitës në bibliotekën e AU konstatoi se biblioteka është e pajisur me fond fizik sic përmendëm dhe më sipër si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, në gjuhën shqipe dhe të huaj, revista shkencore periodike për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore, sipas specifikave të programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi" Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf

	<i>Vizita në institucion</i>
Kriteri 5. Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit.	GVJ, bazuar në referencat si dhe takimin me drejtues të institucionit, stafin akademik, studentët dhe punonjësit e bibliotekës konstaton se, AU mbështet dhe përditëson literaturën në bibliotekë qoftë me libra fizik por edhe me anë të burimeve on-line sipas kërkesave të pedagogëve dhe studentëve. Të gjithë pedagogët dhe studentët e programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” kanë akses pa pagesë në bibliotekë fizikisht cdo ditë sipas orarit të bibliotekës, nga ora 8.00- 16.00 dhe dy herë në muaj edhe të shtunave si dhe nëpërmjet linkut që i jepet nga biblioteka çdo studenti dhe pedagogu për tu futur on line ebSCO.com/academic-libraries, Pitagora, magazinelib.com, U Transparenca, EBSCO; ERIC; Cambrig Journal, pa pagesë për literaturën e nevojshme sipas lëndëve dhe moduleve të programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”. Ref.3.7 - Manual per realizimin e mesimit online 20-21.pdf Ref.3.8 - Manual per perdorimin e platformes online PITAGORA.pdf Ref. 5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka online. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf
j	<i>Vizita në institucion</i> GVJ, konstaton se Biblioteka e AU-së është e pajisur me PC në mënyrë, që studentët të kenë mundësi të aksesojnë bibliotekat on-line të vëna në dispozicion nga AU. AU në dispozicion të studentëve ka një sallë interneti me sipërfaqe 55 m² dhe bibliotekën 72m². Biblioteka është e pajisur me 25 kompjutera dhe programe kompjuterike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve dhe stafit akademik. Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.4.10 - Libraria Online.pdf
Kriteri 7. Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	<i>Vizita në institucion</i> GVJ, gjatë vizitës në AU, në bibliotekë konstatoi dhe vuri re të afishuar mënyrën e organizimit të punës në bibliotekë. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës se për mbarrëvajtjen e punës, bëhet një grafik orari që të mos ketë mbingarkesë në bibliotekë, si dhe orarin e punës. Biblioteka në AU është e hapur në shërbim të studentëve sipas programeve si dhe stafit akademik cdo ditë jave, nga e Hëna në të Premte nga ora 8:00-16:00, biblioteka e AU-së, funksionon edhe ditën e shtunë, 2 herë në muaj sipas nevojave të studentëve për literaturë. Oraret e shërbimit në bibliotekë janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor, duke ditur se studentët e programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”, mësimin e zhvillojnë mbasdite prandaj orari është deri në orën 16.00 ose dhe të shtunave në rast nevojë.

	GVJ nisur nga nr i studentëve të programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”, sipërfaqja e bibliotekës 55m², sipas refrencës, Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf GVJ mendon se janë kapacitetet e mjaftueshme për shfrytëzimin sa më mirë të saj. Vizita në institucion			
Kriteri 8. Biblioteka dhe njësitet përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj, por edhe për performancën e personelit akademik.	GVJ në takimin me drejtues të institucionit, me studentët me stafin akademik, me punonjësit e bibliotekës si inspektimit të ambienteve të bibliotekës vuri re një shfrytëzim maksimal të hapësirave të bibliotekës nga studentët dhe stafi akademik. Punonjësit e bibliotekës qëndrojnë në dispozicion të tyre për hapjen e kartelave individuale për librat fizikë, ose për të ndihmuar në aksesimin on line për literatura të ndryshme. GVJ u informua nga punonjësit e bibliotekës, se ata bëjnë raportin cdo fundvit mbi shfrytëzimin e kapaciteteve të bibliotekës numrin e librave fizikë të qarkulluar nga studentët dhe stafi, shfrytëzimin e bibliotekës on-line, inventarizimin e librave fizikë si dhe kërkesa për fond biblioteke (fizike dhe on-line), bazuar edhe në kërkesat e çdo departamenti sipas programeve, moduleve përkatëse bazuar në përditësimin e syllabuseve të programit të studimit, të Ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”, GVJ në dokumentat e vëna në dispozicion, konstatoi se në raportin vjetor financiar ekziston dhe fondi i bibliotekës, <i>tabela Nr.18</i> të ardhurat dhe financimet e ndryshme për tre vitet e fundit për zërin Libra, i cili miratohet nga Bordi i Administrimit të AU. Ref.R.2.b- Shkresë për pasurimin e bibliotekës me literaturë të huaj 5 (pesë) viteve të fundit. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (Tabela Nr.18 të ardhurat dhe financimet e ndryshme për tre vitet e fundit) Vizita në institucion			
Konkluzione	<i>IAL vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme, për këtë program studimi dhe ka literaturën e nevojshme (literaturë shqip dhe në gjuhë të huaj), jo vetëm për lëndët e përgjithëshme, por edhe për lëndët profesionale, në mbështetje të mësimdhënies dhe të mësimnxënies për studentët e programit të studimit të Parë Bachelor “Fizioterapi”</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.4

Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ konstatoi se AU disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. GVJ bazuar në dokumentacionin e dorëzuar dhe vizitës në institucion, konkludon se AU ka struktura që nisin nga njësia bazë, sekretaria e cila disponon informacionin që lidhet me studentët mbi aktivitetin e tyre akademik nga hyrja në institucion deri në përfundim të studimeve (diplomimit) në programin e studimit të Parë Bachelor “Fizioterapi”. AU ka në dispozicion regjistrat themeltar (fizik), që ne si GVJ i vëzhguam gjatë takimit me sekretarinë mësimore, por ka në funksion edhe sistemin e Pitagorës, i cili është sistemi i lidhur me QSHA dhe RASH. AU e ruan këtë data bazë, duke konsideruar këto të dhëna si pikë e fortë reference për të bërë dhe përpunime statistikore në vazhdim për cilësinë e studentëve në hyrje dhe deri në diplomim. AU përvec sistemit të Pitagorës, menaxhon aktivitetin e brendshëm edhe me platformën on-line U-TRANSPARENCA, i cili është në bashkëpunim me AKSHI-n, me një kontratë pa limit,sipas: Ref.3.8 - Manual per perdorimin e platformes online PITAGORA.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line. Ref.4.9 - Fondi i librave në funksion të departamentit.pdf hh
Kriteri 2. Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ gjatë vizitës në institucion, takim me stafin e IT-së, studentët dhe stafin akademik të institucionit konstatoi se, sistemi për Menaxhimin e Informacionit PITAGORA është i aksesueshëm dhe nga personeli akademik që e përdor atë për aktivitetin në kuadër të procesit të mësimdhënies (leksione, seminare, praktika, detyra kursi, provime të ndërmjetme, provimin përfundimtar). Sistemi i Pitagorës gjithashtu i mundëson studentit të përditësohet në kohë reale me të gjithë informacionet që pedagogu hedh në sistem si vlerësime, frekuentim, silabusin e lëndës etj. (Aksesi online në sistemin PITAGORA) GVJ, vë re se sistemi i brendshëm i menaxhimit është hallk kryesore në AU, jo vetëm në administrimin e informacionit dhe të dokumentacionit të ruajtur, në lidhje me aktivitetin e personelit akademik dhe atij ndihmës akademik, apo personelit administrativ dhe partnerëve të përfshirë në realizimin e programit të studimit të ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”, por edhe për të bërë të mundur kontrollin periodik të aktivitetit mësimor



	të gjithë strukturave të përfshira në procesin mbarëvajtjes së procesit mësimor. Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.1.a- Statuti i Albanian University.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.1.6- Rregullore DIF.pdf Ref.1.7- VKM nr. 603, dt. 24.08.2011 Për ndryshimin e emrit të Universitetit.pdf Ref.2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Ref. 2.14 Studenti pjesë e Senatit Akademik.pdf
Kriteri 3. Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.	GVJ, gjatë vizitës në institucion, në takimet e realizuara me stafin, studentët, sekretarinë, IT etj, ju referua se funksionet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit ka të bëjë me komunikimin e vazhdueshëm dhe në kohë reale midis stafit akademik dhe studentëve, duke bërë të mundur shkëmbimin e materialeve, literaturës, njoftimeve mes pedagogut dhe studentëve. I gjithë informacioni dhe aktiviteti pedagog-studentë, nga ky sistem menaxhimi i ruan këtë aktivitet të personelit akademik, personelit ndihmës akademik, apo personelit administrative. Në sistem janë të hedhura të dhënat për strukturën akademike, të dhënat e studentit vlerësimet kohë pas kohe deri në diplomim pranimin. Sistemin elektronik të Pitagorës e përdor shumë dhe ndihmon në mbarëvajtjen dhe dokumentimin elektronik të punës edhe sekretaria mësimore, ku hedh të dhënat për studentët që nga regjistrimi, transferimet, vlerësimet sipas lëndëve dhe viteve, diplomimin etj. Drejtoria e financave ka akses në sistem për të dokumentuar menaxhimin e tarifave të programit të studimit; bursat për studentët e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”. Ref.3.8 - Manual për përdorimin e platformes online PITAGORA.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line.
Kriteri 4. Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit akademik dhe studentëve.	GVJ, bazuar në RVB, vizita në institucion, takimin me drejtues të institucionit konstaton se, AU për mbarëvajtjen e procesit mësimor, bashkëveprimi institucional staf akademik, ndihmës akademik, administratë dhe studentëve bëhet e mundur komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike krahas sistemit të Pitagorës ka patur në funksion edhe platformën e Microsoft Teams, që mundëson komunikimin interaktiv dhe shkëmbimin të informacionit, të materialeve didaktike dhe informacionit në formë njoftimesh ndërmjet personelit akademik dhe studentëve. Ref.3.8 - Manual për përdorimin e platformes online PITAGORA.pdf

	Ref. 5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.17 të dhëna të plota për platformën on line /IT/bibliotek/ biblioteka on line.
Kriteri 5. Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese.	GVJ, gjatë vizitës në institucion dhe dokumentave referuese të vëna në dispozicion u vu re se, AU ka në dispozicion sisteme të menaxhimit të brendshëm si: Pitagora ,Teams, Google Classroom të cilat u vijnë në ndihmë si pedagogëve dhe studentëve në mënyrë të barabartë, me qëllim që të shkëmbejnë informacion të shpejtë dhe në kohë reale në mënyrë të vazhdueshme, duke i menaxhuar nga zyra, shtëpia apo telefoni aplikacionet në fjalë nga të dyja palët e interesuara ku pedagogu hedh detyra, leksione, libra, link-e, pyetësorë, apo shpall njoftime dhe studenti merr njoftimet, shkarkon leksionet, librat, njoftohet mbi notat, pikët e përfituara nga seminarët, detyrat dhe essetë, etj. Sistemi i menaxhimit me platformat e integruara mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve, duke paraqitur një zgjidhje në kohë të problematikave dhe transparencës në të gjithë aktivitetin mësimor që kanë të bëjnë me studentët e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”, kjo përbën dhe një pikë të fortë të AU. GVJ mendon se sistemi i Menaxhimit të Informacionit siguron monitorimin e mbarëvajtjes, transparencës së procesit të mësimdhënies, sidomos në lidhje me administrimin e provimeve dhe hedhjes së vlerësimeve. Ky sistem shmang vonesën në hedhjen e vlerësimeve dhe në dokumentimin sipas rregullores së provimeve si dhe rritjen e transparencës. Nga ana tjetër, pedagogët, institucioni mund të përdorin të dhënat e hedhura në sistem për përpunime të mëtejshme statistikore në analizat periodike që AU bën për cilësinë e studentëve në vazhdimësi. Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.1.7- VKM nr. 603, dt. 24.08.2011 Për ndryshimin e emrit të Universitetit.pdf Ref.2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Ref.2.14 Studenti pjesë e Senatit Akademik.pdf
Kriteri 6. Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë, ku njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ gjatë vizitës në institucion, takimit me stafin, studimin e faqes zyrtare të institucionit konstaton se, institucioni ka në administrim faqen zyrtare https://au.edu.al/njoftim-per-vazhdimin-e-aplikimeve-per-bachelori-fizioterapi, të cilat janë në përputhje me politikat e transparencës dhe politikat e privatësisë sipas legjislacionit në fuqi ligji i Arsimit të Lartë i IALP 80/2015). Përmbajtja e faqes ofrohet në dy gjuhë njëra është në gjuhën shqipe dhe tjetra anglisht. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku shfaqet informacioni dhe vendime të ndryshme të institucionit. Llogaritë në

	rrjetet shoqërore janë gjithashtu mundësi informimi për njoftime të ndryshme. Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf Ref.2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf			
Konkluzione	<i>Bazuar në RVB, dokumentat e vëna në dispozicion si dhe guidën në institucion mendojnë se AU, disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi"</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi IV.5	
Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	GVJ bazuar në dokumentat e vëna në dispozicion, RVB, takimi me drejtues të njësisë kryesore dhe takimi me punonjësit e zyrës ekonomike, konstatoi se ekziston një raport financiar për mbulimin e shpenzimeve në nivelin institucional i cili hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve sipas referencës 5. Tabelat përmbledhëse: (tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit) GVJ konstaton se tek financimet hyjnë granti i akorduar nga tarifat e studimeve të studentëve dhe fondet jopublike të shoqërisë UFO SHPK, të cilat janë në rritje nga viti në vit sipas sipas referencës 5. Tabelat përmbledhëse: (tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit). Granti i akorduar është i plotë dhe siguron financim për të gjithë programin e studimit bachelor në "Fizioterapi", duke mbuluar kostot deri në përfundim të programit. Institucioni bazuar dhe në udhëzimet e MAS, garanton bursa për studentët ekselentë, po ashtu për studentët me prindër invalid ose ndihmë ekonomike, policëve të rënë në detyrë, fëmijë romë etj. Burim kryesor financimi si IAL jopublike është, granti i mësimdhënies i akorduar nga Shoqëria UFO SHPK, pasi AU është pjesë e kësaj shoqërie, tarifat e shkollimit, ndërsa një kontribut

	tjetër lidhet me aktivitetet dytësore, që AU ofron (qeradhënie, paslestra, kënde të lojrave parkim etj). Specifike për vitet e fundit është edhe kontributi i granteve për kërkim, siguruar nga projekte të ndryshme. Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti. Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit. Institucioni për të parë mbarëvajtjen e financave në mënyrë të vazhdueshme bën auditim të brendshëm, por edhe nga ministria e për ecurinë dhe legjitimitetin e veprimtarisë së tij. Për secilin vit akademik institucioni harton raportin vjetor lidhur me kostot për secilin program studimi për të kontrolluar më lehtë ecurinë dhe vazhdimësinë e realizimit të programit të studimit. Ref.5.Tabelat përmbledhëse tabela nr.18,nr.20. Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit Ref.5.Tabelat përmbledhëse tabela Nr.19 Të dhëna për kërkiminhkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti.
--	--

Kriteri 2. Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.	Bazuar nëdokumentat e vëna në dispozicion si dhe takim me drejtuesit e njësisë kryesore GVJ, u informua se në cdo fund viti bëhet plani i financimit nga njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit bazuar në orët e programit të studimit Bachelor në “Fizioterapi”. Plani i financimit të programit të përmban financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës dhe aksesin në bibliotekat on-line, materiale dhe pajisje laboratoritrike. Ky plan financiar i dërgohet senatit të universitetit nga njësia kryesore, Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit, dhe ia kalon më pas Bordit të Administrimit për miratim. Bordi i Administrimit nga ana e tij miraton planin financiar dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Plani i financimit hartohet në nivel institucional. Në këtë plan planifikohen fonde për kërkimin shkencor, projektet vendase, apo të huaja të përfituara, si dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit. Ref.5.Tabelat përmbledhëse: tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit. Ref.5.Tabelat përmbledhëse tabela Nr.19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti Ref.Tabela Nr.20 Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit
Kriteri 3. Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij.	GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni AU harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara për deklarimin e dorëzimit e pasqyrave financiare. GVJ u informua se, në fund të cdo programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. GVJ u informua se institucioni cdo fund viti pasi vlerëson koston e studimit dhe në bazë të vititit të mëparshëm propozon kuotat e studimeve për cdo program si dhe koston e studimeve përkatëse. Këto kuota dhe kosto propozohen nga njësitë bazë, dërgohen në njësinë kryesore dhe miratohen në senatin akademik istitucional. Institucioni bën auditim të brendshëm 2 herë në vit për kryesisht për programet e studimit si dhe po ashtu pret auditim nga jashtë institucionit nga Ministria e Financave një herë në vit kryesisht për anën financiare të studimit. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit. Audit i jashtëm



	është dhe vlerësimi nga ASCAL. I gjithë aktiviteti financiar i institucionit, është subject auditimi nga MAS. Misioni i auditimit të brendshëm apo të jashtëm konsiston në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, auditimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, auditimin e krijimit dhe menaxhimit të të ardhurave, etj. Institucioni me marrjen e raportit të auditit merr masa për hartimin e një plan veprimi me qëllim implementimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve të grupit të auditit. Raporti i auditit përcillet në mënyrë periodike departamenteve, dekanatit, rektorit edhe Bordit të Administrimit. Auditet në përgjithësi bëhen nga MAS, të cilat bëhen pothuaj cdo vit për infrastrukturën dhe financat e AU. Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.1.a- Statuti i Albanian University.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.1.7- VKM nr. 603, dt. 24.08.2011 Për ndryshimin e emrit të Universitetit.pdf Ref.1.8- Kodifikimi i programeve të studimit.pdf Ref.1.9 - Raport Vjetor Institucional v.a 2022-2023.pdf Ref.2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.23 Studimi i tregut të punë
Kriteri 4. Institucioni raporton deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës.	GVJ u informua nga drejtuesit e institucionit se institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional. Plani financiar i hartuar parashikon që të garantojë vazhdimësinë e ofrimit të programit të studimit. GVJ konstatoi se, në mes dhe në fund të një program studimi, në periudhën Mars-Maj, institucioni rishikon koston e një program studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit, për sa i përket propozimit për koston e studimeve përkatëse si dhe kuotat e studimeve për cdo program. Këto kuota dhe kosto propozohen nga njësitë bazë, dërgohen në njësinë kryesore dhe miratohen në senatin akademik institucional dhe më pas kalojnë në Bordin e Administrimit Institucional të AU. Ref 1. Ligji i IAL-së.pdf Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.1.6- Rregullore DIF.pdf Ref.1.9 - Raport Vjetor Institucional v.a 2022-2023.pdf



	Ref.5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.23 Studimi I tregut të punë) Referencës 5. Tabelat përmbledhëse: tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit. Ref. 5. Tabelat përmbledhëse tabela Nr.19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti Ref.5.Tabela Nr.20 Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit
Kriteri 5. Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësishë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventuale të financimit të programeve të studimeve.	GVJ bazuar në takimin me drejtuesit e institucionit, dokumentat e vëna në dispozicion mendojnë se AU, garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi". GVJ gjithashtu, konstaton se, buxheti financiar fillon të hartohet që në muajin Mars -Maj të çdo viti dhe miratohet nga Rektorati, Senati Akademik dhe Bordi Administrimit. Për zbatim të këtij buxheti, ngarkohet Administratori dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit. Projekt buxheti hartohet në mënyrë të tillë ku përcaktohet çdo muaj njëraport i saktë i të ardhurave dhe shpenzimeve, duke përcaktuar dhe rezervat e nevojshme për shpenzimet që kanë prioritet në vazhdimësi. Për çdo veprim blerje dhe shitje Drejtoria e finances dhe Buxhetit, pajiset me urdhër të miratuar nga Administratori. Veprimet e AU-së kryhen vetëm nëpërmjet sistemit të Thesarit dhe atij bankar duke siguruar transparencë të plotë të shpenzimeve. GVJ gjatë takimit me drejtues të institucionit, u informua se, AU dëshmon ka qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen. Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Evidenca 1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf Evidenca 1.6- Rregullore DIF.pdf Evidenca 1.9 - Raport Vjetor Institucional v.a 2022-2023.pdf Evidenca 2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Evidenca. 5. Tabelat përmbledhëse (tabela Nr.23 Studimi I tregut të punë) Referencës 5. Tabelat përmbledhëse: tabela Nr.18 Të ardhurat dhe financime të ndryshme të tre viteve të fundit. Referencës 5. Tabelat përmbledhëse tabela Nr.19 Të dhëna për kërkimin shkencor të stafit akademik në rang departamenti/fakulteti Tabela Nr.20 Të dhëna për bashkëpunime kombëtare dhe ndërkombëtare të institucionit
Konkluzione	GVJ bazuar në RVB, guidën në institucion dhe referencat përkatëse mendojnë se institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve për programin e studimit Bachelor në "Fizioterapi"

Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

Standardi V.1	
Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.	GVJ gjatë bashkëbisedimit me drejtues të institucionit, studentët, koordinatoren e programit, sekretarinë mësimore, RVB, referencave të vëna në dispozicion konstatoi se ky institucion harton politika dhe procedura të sakta gjatë vitit akademik të studentëve (në hyrje dhe në përfundim të studimeve), në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi. Ndiqet një radhë pune si më poshtë: në bazë të Dekreteve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë. Procesi i pranimeve në AU organizohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi. Pranimi në këtë program studimi <i>Bachelor në "Fizioterapi"</i> është me numër të caktuar kuotash. Çdo vit senati i AU miraton kuotat e pranimi, kriteret e pranimi, vendet e disponueshme, për të gjitha kategoritë dhe publikohen në faqen e internetit të institucionit. Për sa më sipër kuotat për çdo kategori studentësh caktohen çdo vit dhe publikohen në faqen e internetit nëpërmjet njoftimeve të pranimi sipas Ligjit të Arsimit të Lartë në Shqipëri Nr. 80/2015 si dhe dhe dekreteve e vendimeve të nxjerra çdo vit nga Ministria Shqiptare e Arsimit, Sportit dhe Rinisë të cilat përcaktojnë procedura të regjistrimit dhe afatet përkatëse. Një kopje e këtyre vendimeve të Senatit Akademik në formë shkresore-letër dhe në formë elektronike dërgohet në MASR. Procedurat e pranimi bëhen të njohura në faqen zyrtare të AU me anë të shpalljeve dhe njoftimeve të pranimi, të cilat përmbajnë informacione të hollësishme për vendet e disponueshme dhe kriteret e pranimi. Po ashtu në kuotat e pranimi, ka kuota të caktuara jo vetëm për shtetas të Shqipërisë dhe vendeve jo nga BE, kuota për transferime, të gjithë studentët të cilët duan të regjistrohen në AU për programin e studimit <i>Bachelor në "Fizioterapi"</i>, paracaktohen dhe miratohen nga senati. Studentët nga hyrja deri tek diplomimi i tyre është i rregulluar në bazë të

	akteve ligjore e nënligjore në fuqi të ardhura nga MAS, rregullores dhe statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Rregjistrimet bëhen me raunde sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe kritereve, kuotave të miratuara më parë. Institucioni dhe njësia përgjegjëse për ofrimin e programit kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse. Ref 1. Ligji i IAL-së.pdf Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.5.3 - Axxhenda e javës orientuese.pdf Ref.5.4 - Udhëzues Orientues për Maturantët.pdf Ref.5.5 - Rregullore e këshillit studentor.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres së Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres së Karrierës dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Eëork and Study.pdf Ref.5.9.b - Panairi i punës.pdf Ref.5.10 - Raport mbi mesataren në hyrje dhe në dalje të studentëve								
Kriteri 2. Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.	Gjatë vlerësimit të referencave, vizitës në institucion, GVJ konstaton se AU nëpërmjet politikave dhe procedurave, garanton barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët dhe studentët e programit të studimit Bachelor në "Fizioterapi". (Ligji Nr. 9970, datë 24.07.2008 "Për Barazinë Gjinore në Shqipëri" Ligji Nr. 96/2017 "Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë", Ligji Nr. 93/2014 "Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara" etj). Institucioni respekton të drejtat dhe barazinë e çdo individi, duke respektuar bindjen fetare; origjinën sociale; përkatësinë ndaj një grupi të caktuar; orientimi seksual dhe identiteti gjinor; bindjen fetare; etninë etj. Në takimin me sekretarinë konstatoam se ekzistonin rregjistrat të cilat tregonin të gjithë praktikën e rregjistrimit apo të rregjistrimit të studentëve fitues sipas kritereve të paracaktuara, pa bërë dallime se kujt i përkisnin këto kuota (student shqiptar, Kosovës, Malit të Zi, Maqedonisë dhe Bosnjë– Hercegovinës).								
	<table><tr><td>Viti akademik</td><td>Kuota të studentëve të kërkuara dhe</td><td>Student të transferuar</td><td>Numri studentëve të rregjistruar</td></tr><tr><td></td><td></td><td></td><td></td></tr></table>	Viti akademik	Kuota të studentëve të kërkuara dhe	Student të transferuar	Numri studentëve të rregjistruar				
Viti akademik	Kuota të studentëve të kërkuara dhe	Student të transferuar	Numri studentëve të rregjistruar						

përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjesshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.	studimeve të mëparshme ose të pjesshme, vlerësimi i dijeve dhe diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku pasi janë të përcaktuara në rregulloret e studimit të Fakultetit dhe departamentit si dhe online në ëeb e AU. Gjatë takimit me studentët u konfirmua se institucioni ndjek një politikë të orientimit dhe këshillimit të tyre. Informacioni është i aksesueshëm nga burime si: sekretaria mësimore, faqja zyrtare është gjithashtu e aksesueshme on-line (internetin e AU), ku gjënden dhe aktet rregullatore, të cilat i vihen në dispozicion studentëve të ciklit të Parë të studimeve Bachelor "Fizioterapi" Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, si dhe nga trojet. Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve. Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik, institucioni informon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.	Përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit (open day), fletushka të ndryshme, marketing në studio dhe media të ndryshme, duke bërë informimin e publikut të interesuar për diplomat që menaxhon AU-ja programet, masterat, kuotat, kriteret përkatëse, për cdo program studimi, përmes portalit U- albania dhe faqes zyrtare të univesitetit. GVJ u informua se, institucioni dhe e gjithë procedura që nga aplikimi deri te pranimi i studentëve është publike dhe relizohet në mënyrë fizike sipas vendimeve të MAS për pranimet e studentëve në Ciklin e Parë të studimeve Bachelor në "Fizioterapi" Të dhënat për kriteret , kuotata dhe tarifat financiare për studime në Ciklin e Parë të studimeve Bachelor në "Fizioterapi". Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve. Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf
Kriteri 6. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret të veçanta për	Bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni, GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara. Bazuar në dokumentacionin e vënë në



përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara.	dispozicion nga institucioni GVJ konkludon se institucioni parashikon kuota të posaçme dhe kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, bazuar dhe në Ligj Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe udhëzimet e vazhdueshme të MAS. Ref.5.Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve. Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf
Kriteri 7. Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera.	GVJ, gjatë vlerësimit konstatoi se AU harton dhe publikon kriteret dhe kuotat dhe përzgjedhjen për kandidatët shqipëtar dhe nga trojet sipas kriterëve për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të marginalizuara, bazuar dhe në Ligj Nr. 9970, datë 24.07.2008 “Për Barazinë Gjinore në Shoqëri” Ligji Nr. 96/2017 “Për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 93/2014 “Për Përfshirjen dhe Aksesueshmërinë e Personave me Aftësi të Kufizuara si dhe udhëzimet e vazhdueshme të MAS”. Institucioni informon përmes faqes zyrtare kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve nga shtete të tjera përmes kuotave të vecanta. Institucioni para çdo viti akademik planifikon kuotat, kriteret sipas programit, infrastrukturës së institucionit, numrit të stafit akademik pas propozimeve nga dekanati, kalojnë në rektorat dhe miratohen në senat dhe dërgohen për miratim në MAS. Propozimet e institucionit janë të miratuara nga MAS , bazuar edhe në referencat e mëposhtme dhe gjenden edhe në faqen zyrtare të institucionit https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret- e- pranimit. Ref.5.Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve. Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf



Kriteri 8. Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit.	GVJ bazuar në dokumentat e dorëzuar nga institucioni, takimi me stafin, sekretarinë mësimore, studentët e programit të Ciklit të Parë Bachelor “Fizioterapi”, zyrën e burimeve njerëzore, konkludon se në fillimin e çdo viti akademik, realizohen procedurat përkatëse të ndihmës ekonomike dhe bursave për shtresat në nevojë, sipas udhëzimeve të ardhura nga MAS si dhe me vendim të Bordit të Administrimit AU. <i>https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret- e- pranimit.</i> Ref.5.Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve. Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres se Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres se Karrieres dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf			
Konkluzione	GVJ mendon se ky standart “Përmbushet plotësisht” , pasi institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”, bazuar në ligjshmëri dhe udhëzimet e ardhura nga MAS, si dhe referencat, vizita në institucion dhe RVB.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.2	
Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.	
Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.	GVJ, duke ju referuar dokumentacionit të dorëzuar, rregullores së programit të studimit, faqes zyrtare të web: https://albanianuniversity.edu.al/sq/kriteret- e- pranimi/ si dhe takimit me përfaqësues të tij, konkludon se i gjithë informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren mësimore të programit të studimit dhe aktet e tjera rregullatore. Gjatë takimit me studentët, GVJ konstatoi se ata njihen me rezultatet e tyre nëpërmjet platformës online Pitagora. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e



programit të studimeve si dhe mundësinë e transferimit të studimeve, instrumentat e realizimit të vlerësimit të njohurive për lëndë të ndryshme, komponentët përbërës të vlerësimit total të lëndës, organizimi i provimeve, realizimi i praktikave, diplomimi, ndërpreja dhe rifillimi i studimeve, etj. Studentët informohen edhe nëpërmjet posterave dhe takimet në ditët e hapura me maturanët. Po ashtu në ditën e parë të fillimit të vitit akademik studentët realizojnë takim me drejtues të fakultetit si dhe pedagogë ku ata kanë mundësinë të njohin infrastrukturën, auditorët, të drejtat dhe përgjegjësië, programin e studimit dhe modulet përkatëse etj. Institucioni vë në dispozicion sekretarinë mësimore. Studenti akseson ecurinë akademike përmes llogarisë së tij në platformën Pitagora, ku ruhen të dhënat akademike ndër vite dhe studentit informohet për procedurat e përparimit akademik dhe kalimin nga një vit akademik në tjetrin, sipas tabelës më poshtë

Viti akademik	Numri studentëve të rregjistruar total	Nota mesatare ne hyrje	Nota mesatare ne dalje
2021-2022	60	7.62	7.62
2022-2023	46	7.63	7.52
2023-2024	36	7.52	7.2

Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 cilësia në hyrje dhe dalje të studentëve

Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf

Ref.2.8 Vendim Senhjuuuuuuhati për miratimin e kuotave.pdf

Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf

Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf

Ref.5.9.a - Panairi Eork and Study.pdf

Ref.5.3 - Axxhenda e javës orientuese.pdf

Ref.5.4 - Udhëzues Orientues për Maturanët.pdf

Kriteri 2. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

GVJ vlerëson se AU informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme. Kjo realizohet nëpërmjet Drejtorisë së Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Sekretaria mësimore pranë njësisë kryesore (fakultetit) dhe Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë informojnë studentët në lidhje me procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme.

Institucioni për të bërë të mundur ekuivalentimin e programeve të studimeve për studentët që duan të transferojnë studimet në AU, ngre një komision i cili bën ekuivalentimin lëndëve bazuar në programin e studimit të ciklit të parë fizioterapi të aplikantëve të ardhur nga institucione të ndryshme të IAL(transferime) dhe kur program përputhet

	në 70% të tij me programin e AU , studentët mund të rregjistrohen në Ciklin e Parë Bachelor në “Fizioterapi”. Studenti i cili dëshiron të rregjistroj studimet nga AU, informohet për të gjitha procedurat, kriteret që ndiqen në rastin e transferimit të studimeve. GVJ konstatoi një procedurë rregjistrimi në vitin 2021-2022 dosja e studentit përmbante (kërkesën e studentit për tu rregjistruar dhe arsyen e rregjistrimit, miratimi nga decani, vërtetimi rregjistrimit që I jepet edhe studentit). Gjithë procedura e transferimeve menaxhohet mbi bazën e dokumenteve, si plani mësimor dhe programet e lëndëve, si dhe procedurat e parashikuara në rregulloret e studimeve të institucionit. Ref 1. Ligji i IAL-së.pdf Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekësore (2).pdf Ref.5.4 - Udhëzues Orientues për Maturantët.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres së Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres së Karrierës dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf
Kriteri 3. Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.	GVJ, bazuar në dokumentacionin referues, gjatë vizitës në sekretarinë mësimore konstatoi se institucioni disponon dosjen personale (rregjistrin) të çdo studenti, në të cilën janë të detajuara informacionet nga dita e rregjistrimit deri te procedurat e vlerësimit të dijeve. Po ashtu rregullorja e institucionit, syllabuset parashikojnë elementet përbërës të vlerësimit dhe peshën specifike të tyre në raport me vlerësimin total të cilat janë të reflektuara në programin dhe silabusin e secilës lëndë sipas specifikave përkatëse vlerësimi i detyrimeve të lëndës 20%, detyra e kursit 10-30%, provimi përfundimtar 50-70%, vlerësimi për lëndët praktike: vlerësimi i vazhdueshëm performance në qendrat përkatëse dhe provimi praktik me gojë para një komisioni. Në fillim të vitit akademik, që ditën e parë pedagogu shpjegon përmbajtjen e syllabusit të lëndës dhe studentëve u vihet në dispozicion, duke patur parasysh temat, seminarët, provime të ndërmjetme , provime praktike, detyrime lëndore dhe provimi përfundimtar. Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf Ref.2.5 - Koordinatorin e programit të studimit.pdf Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.2.11 Model syllabusi.pdf
Kriteri 4. Institucioni i arsimit të lartë informon	GVJ gjatë shqyrtimit të dokumentacionit të dorëzuar, RVB, guidës në institucion, konstatoi se AU ka hartuar rregulloren e studimeve. Programi

studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.	i studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”, në AU zgjat 6 semestra, një vit kademik me 60 kredite dhe përfundon me provimin përfundimtar të diplomimit në fund të vitit të tretë, punimin për diplomim për studentët me një provim me shkrim i përbërë nga pyetje me quize dhe pyetje me shtjellim (zgjidhje rastesh), pasi studenti ka përmbyllur të gjitha detyrimet akademike dhe ekonomike në AU. Studenti me i mire jep provimin përfundimtar të diplomes me punim teme diplome. Në rregulloren e AU-së, departamenti përgjegjës në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, diplomimit. Rregullorja e diplomimit, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit. GVJ konstaton se studentit I vihet në dispozicion Banka e pyetjeve orjentuese për provimin përfundimtarë, model teze provimi etj. GVJ, konstaton se ,procedurat për provimin e diplomës, janë në dispozicion të studentëve jo vetëm në faqen zyrtare të institucionit, por edhe ju bëhen me dije pranë departamentit aposekretarisë mësimore. Institucioni përcakton në mënyrë të detajuar planin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogun udhëheqës, procesin e shkrimit të tezës, kalendarin e seancave metodologjike, e deri tek formatimi konkret i punimit, dorëzimin dhe mbrojtjen. Fazat kohore të dorëzimit dhe mbrojtjes së diplomës bëhen të ditura në fillim të vitit akademik. Ref. 1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref. 1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.3.15 - Banka e pyetjeve orjentuese për provimin përfundimtarë.pdf Ref.3.16 - Model teze provimi.pdf Ref.3.17 - Manuali i punimit të diplomës.pdf Ref.3.18 - Diplomat e mbrojtura në vitet 2019-2024.pdf Ref.3.19 - Model diplome të programit të studimit Bsc në Fizioterapi.pdf Ref.3.20 - Modeli i suplementit të diplomës të programit të studimit Bsc në Fizioterapi
Kriteri 5. Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit.	GVJ konstatoi nga dokumentacioni se AU organizon takime të hapura për informimin e studentëve që kanë Maturën Shtetërore, për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”, po ashtu publikon spote promovuese për programin e studimit dhe fletëpalosje të ndryshme gja të ditëve të informimit të maturantëve(open day). Gjatë vizitave në institucion GVJ konstatoi se AU ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin e studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programet e studimit. Takimet janë të organizuara (open day) dhe marrin pjesë pedagogët e njësive bazë, anëtarë të personelit akademik, të cilët organizojnë takime periodike me studentë që kanë mbaruar ciklin e parë të studimeve Bachelor. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të studentave të




	interesuar për të vazhduar studimet në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi" grupe pedagogësh që japin informacionin e nevojshëm në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në AU dhe nga AU tek universitetet me programe të ngjashme brënda dhe jashtë shtetit. GVJ konstatoi nga dokumentacioni dhe takimi me stafin akademik se AU organizon takime të hapura për informimin e maturantëve për programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi", institucioni jep informacion të hollësishëm lidhur me mundësitë në tregun e punës për këtë program studimi. Ref.1. Ligji i IAL-së.pdf Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucional 2023-2028.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.5.4 - Udhëzues Orientues për Maturantët.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Evidenca 2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres së Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf Ref.5.8 - Rregullore e Zyres së Karrierës dhe Alumnit.pdf Ref.5.9.a - Panairi Work and Study.pdf Ref.5.9.b - Panairi i punës.pdf Ref.4.7 Infrastruktura e Fakultetit Njësive bazë.pdfA Ref.4.8 - Lista e laboratoreve DIF.pdf			
Konkluzione	<i>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve në programin e Ciklit të Parë Bachelor "Fizioterapi", pasi AU ka strukturë (Drejtoria juridike, Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI) që merret me gjurmimin ematurantëve dhe studentëve dhe organizimin e ditëve të hapura për informimin e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor "Fizioterapi", që ofron AU.</i>			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.3

Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.



Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.	GVJ në bazë të dokumentave referuese, planet mësimore, rregullore, statutit, takimit me drejtues të institucionit, sekretarinë mësimore, studentët konstaton se, AU vendos në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit të programit mësimor dhe kohëzgjatjes së programit të studimit. Informacionin studentët e marrin nëpërmjet takimeve me stafin akademik që i pret në institucion në momentin që interesohen për programet e studimit, nëpërmjet kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, si dhe vënies në dispozicion të studentëve të rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit. Bazuar në programin e studimit dhe rregulloret e AU që ndihmojnë dhe rregullojnë realizimin e programit mësimor, studentëve ju bëhet me dije që programi ka 180 kredite, në një vit akademik, i ndarë në 6 semestre, nga 2 semestra për cdo vit akademik (sem I+II) me nga 15 javë mësimore, cdo semester me nga 30 kredite secili. Në takimin me komisionin e kurrikulave, bazuar në udhëzimin të MAS si dhe Rregulloren e AU në program vihet re se 1 kredit orë mësimore, konvertohet sipas udhëzimeve përkatëse duke përfshirë sipas lëndëve (orë leksioni, orë seminari, praktika lëndore, laborator, praktika profesionale). Ditën e parë bëhet takim informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit, syllabusin, vlerësimin, literaturën bazë dhe të rekomanduar. Në vazhdim sigurohet asistencë e posçame nga personeli ndihmës mësimor për familjarizimin e studentëve me procesin mësimor. Informacionet e hollësishme mbi kreditet, lëndët, orët etj studentët i gjejnë dhe në systemin on-line të Pitagorës për programin e studimit (kurrikul) <i>Cikli I Parë Bachelor në "Fizioterapi"</i> GVJ konstaton se programi studimit <i>Cikli I Parë Bachelor në "Fizioterapi"</i>, ka një shpërndarje sipas udhëzimeve të MAS si dhe kodifikimin e programit sipas, <i>Referencës 5.Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.9 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E)</i>, si më poshtë: 1-Lëndë bazë (A) 15%-20% Kredite 2-Lëndë karakterizuese(B) 50%-55% Kredite 3-Lëndë ndërdisiplinore integruese (C) 12%-15% Kredite 4-Lëndë plotësuese(D)10%-15% Kredite 5-Detyrime përmbyllëse(diploma) (E)3%-5 % Kredite Referencës 5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.9,10,11,12.1 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E), Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf

	Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf Ref. 2.5 - Koordinator i programit të studimit.pdf Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf
Kriteri 2. Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	GVJ bazuar në referencat e vëna në dispozicion, takimin me drejtues të institucionit, takimi me stafin akademik, sekretarinë mësimore si dhe takimi me studentët konstaton se koordinatori i programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”, mban lidhje të vazhdueshme me studentët. AU informon studentët në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve dhe ve në dispozicion të tyre, informacion të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese të programit të studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”. Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për kohëzgjatjen e programit të studimeve edhe nëpërmjet Ëeb-it të AU. Çdo fillim viti akademik në faqen ëeb të AU, në hapësirën e FSHM që ofron programin e studimit bëhet publike struktura e vitit akademik. Informacioni i nevojshëm publikohet në stendat e holleve të universitetit, guida, rregullore dhe fletëpalosje, si dhe elektronikisht. Në formë të detajuar studentët kanë akses mbi ngarkesat, temat për çdo javë mësimore dhe literaturat e detyrueshme dhe ato të rekomanduara, detyrat apo diskutime të ndryshme, kreditet përkatëse, të cilat janë të shprehura qartë dhe në syllabuset e lëndëve të ndryshme. Studentit i akseson të gjitha të dhënat nëpërmjet llogarisë të dedikuar të sistemit të Pitagorës dhe faqes zyrtare on -line të AU, <i>Akresi online në systemin PITAGORA</i>) Studentët asistohen gjatë gjithë kohës nga stafi pedagogjik dhe sekretaria mësimore, koordinatori për cdo paqartësi. Në fillim të çdo semestri, studentëve u vihet në dispozicion orari dhe ngarkesa mësimore semestrale. Po ashtu ora e parë studentët marrin info të detajuar nga pedagogët e lëndëve për syllabusin përkatës ku shprehen qartë: kreditet, kodi lëndor, raporti lexion: seminar: laborator: praktik, temat, literaturë bazë dhe literaturën e rekomanduar, format e kontrollit dhe vlerësimit, detyrimet për lëndën (projekte, detyra kursi), niveli i detyrueshëm i frekuentimit të lëndës Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.9,10,11,12.1 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E), Ref.5. Tabelat përmbledhëse Tabela 14: elementët përbërës të syllabusit sipas VKM 41/2018 Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Ref.2.2 Plan program.pdf Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf Ref.2.5 - Koordinator i programit të studimit.pdf

	Ref.2.6 - Syllabusët e lëndëve.pdf elementët përbërës të syllabusit sipas VKM 41/2018																				
Kriteri 3. Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës.	GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion, dhe gjatë takimeve në institucion, konstaton se AU, informon studentët në mënyrë të vazhdueshme për tregun e punës dhe kriteret e tij. Institucioni i kushton një vëmendje të veçantë orientimit të studentëve drejt tregut të punës, si në rang universiteti nëpërmjet Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ashtu si edhe Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI, e cila ka dy zyra në institucion të cilat u japin studentëve informacione mbi mundësinë e punësimit. Nëpërmjet organizimit të praktikave mësimore në institucionet partnere, studentëve me performancën më të mirë u ofrohet mundësi punësimi reale ose projektet bashkëpunuese me AU bazuar në marrëveshjet e bashkëpunimit, sipas referencës. GVJ u informua nga zyra e karrierës se AU, 6 muaj pas mbarimit të programit mësimor, nëpërmjet e-mail, nr të kontaktit të studentëve merret informacion për punësimin e tyre konkretisht sipas viteve akademike dhe Referencës 5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve në vite si më poshtë: <table><tr><th>Viti akademik</th><th>Numri total i të diplomuarve</th><th>Numri total i të punësuarve sipas diplomës</th><th>Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>79</td><td>45</td><td>13</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>63</td><td>19</td><td>14</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>46</td><td>16</td><td>11</td></tr><tr><td>Totali</td><td>188</td><td>80</td><td>38</td></tr></table> Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve në vite Ref.2.13 - Studimi i Tregut të Punës.pdf Vizita në institucion	Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve sipas diplomës	Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës	2020-2021	79	45	13	2021-2022	63	19	14	2022-2023	46	16	11	Totali	188	80	38
Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve sipas diplomës	Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës																		
2020-2021	79	45	13																		
2021-2022	63	19	14																		
2022-2023	46	16	11																		
Totali	188	80	38																		
Kriteri 5. Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet përmes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm	Nga takimi me studentët, drejtues të institucionit, stafin akademik, sekretarinë GVJ konstaton se AU vë në dispozicion të studentëve informacionin, dokumentacionin dhe udhëzues të posaçëm për lëndët dhe veprimtarinë formuese të cilat shprehen qartë dhe në syllabusët e lëndëve të programit të studimit të ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”. Studenti i akseson të dhënat nëpërmjet llogarisë personale (portali i studentit) në platformën Pitagora, që ata marrin në momentin e regjistrimit në AU nga Zyra e IT, nga ku kanë të drejtë të futen në Sistemin																				

nga studentët edhe në distancë.	e Menaxhimit të Informacionit edhe në distancë, on-line përmes platformës studentët mund të shohin të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe me pedagogët e lëndëve dhe moduleve. Ky system është lehtësisht i aksesueshëm prej studentëve , pedagogëve edhe nga telefonat e tyre celularë, pa pagesë dhe në cdo kohë. https://au.pitagora.rash.al/login Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.3.b- Rregullore e Përgjithshme AU.pdf Ref.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.9,10,11,12.1 Plani mësimor sipas veprimtarive (A-E), Ref.5. Tabelat përmbledhëse Tabela 14: elementët përbërës të syllabusit sipas VKM 41/2018 Ref.2.1 - Rregullore e Programit të Studimit Bachelor Fizioterapi.pdf Evidenca 2.2 Plan program.pdf Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdf Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf Ref.2.5 - Koordinatorin e programit të studimit.pdf Ref.3.8 - Manual për përdorimin e platformës online PITAGORA.pdf Ref.4.11 - Faqja eeb e Universitetit.pdf Ref.5.6 - Manuali i Studentit.pdf Ref.5.7 - Rregullore e Zyres së Koordinimit dhe Mbeshtetjes Ndaj Studenteve.pdf			
Konkluzione	GVJ referuar dokumentacionit të dorëzuar, faqes zyrtare web të AU si dhe vizitës në institucion GVJ konkludon se ky standart “Përbushet plotësisht”, pasi Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm që në fillim të vitit akademik, për objektivat, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit të Ciklit të Parë të Studimit Bachelor në “Fizioterapi” për rezultatet e pritshme të të nxënës dhe mundësitë e punësimit.			
Shkalla e përmbushjes së standardit	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Standardi V.4

Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi deri në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
Kriteri 1. Institucioni i arsimit të lartë disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e	GVJ nga takimi me stafin akademik, me studentët , me zyrën e karrierës, sekretarinë si dhe pas shqyrtimit të dokumentacionit të grupit të vetëvlerësimit, dhe gjatë takimeve të GVJ në institucion, u konstatuan se Njësia e Këshillimit të Karrierës dhe ALUMNI asiston në gjurmimin e

Adresa: “Rruga e Durrësit”
Pranë gjim. «Q. Stafa», Tiranë
Tel: +355 (0) 222-43423

Web site: www.ascal.al

E-mail: info@ascal.al

të diplomuarve, në programin e studimit.	studentëve dhe ka krijuar një databazë të të dhënave të gjurimit të studentëve, e cila përditësohet me të dhëna çdo vit. GJV referuar dokumentacionit dhe vizitës në institucion konstatoi se numri i studentëve të regjistruar në këtë program studimi të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi” sipas Ref.5.Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 Cilësia e studentëve në hyrje ,dalje, rregjistrimet.është si më poshtë vijon:																						
	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>Kuota të studentëve të kërkuara dhe miratuara në MAS</th><th>Numri studentëve të regjistruar</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>115</td><td>51</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>90</td><td>68</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>51</td><td>51</td></tr><tr><td>2023-2024</td><td>120</td><td>39</td></tr><tr><td>Totali</td><td>406</td><td>209</td></tr></table>				Viti akademik	Kuota të studentëve të kërkuara dhe miratuara në MAS	Numri studentëve të regjistruar	2020-2021	115	51	2021-2022	90	68	2022-2023	51	51	2023-2024	120	39	Totali	406	209	
	Viti akademik	Kuota të studentëve të kërkuara dhe miratuara në MAS	Numri studentëve të regjistruar																				
	2020-2021	115	51																				
	2021-2022	90	68																				
	2022-2023	51	51																				
	2023-2024	120	39																				
	Totali	406	209																				
	Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve në vite.																						
	<table><tr><th>Viti akademik</th><th>Numri total i të diplomuarve</th><th>Numri total i të punësuarve sipas diplomës</th><th>Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës</th></tr><tr><td>2020-2021</td><td>79</td><td>45</td><td>13</td></tr><tr><td>2021-2022</td><td>63</td><td>19</td><td>14</td></tr><tr><td>2022-2023</td><td>46</td><td>16</td><td>11</td></tr><tr><td>Totali</td><td>188</td><td>80</td><td>38</td></tr></table>				Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve sipas diplomës	Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës	2020-2021	79	45	13	2021-2022	63	19	14	2022-2023	46	16	11	Totali	188	80
Viti akademik	Numri total i të diplomuarve	Numri total i të punësuarve sipas diplomës	Numri total i të punësuarve jo sipas diplomës																				
2020-2021	79	45	13																				
2021-2022	63	19	14																				
2022-2023	46	16	11																				
Totali	188	80	38																				
Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 Cilësia e studentëve në hyrje dalje, rregjistrimet																							
Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve në vite																							
Kriteri 2. Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses	AU disponon statistika të sakta vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Fizioterapi”si dhe për të gjitha programet e studimit që ofron AU. AU disponon statistika të sakta vjetore për numrin e transferimeve, rregjistrimeve, largimet ose crregjistrimet,para përfundimit të programit apo mos përfundimit me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve për arsye të ndryshme. GJV në shikimin fizik të rregjistrave themeltar të sekretarisë mësimore konstatoi një rregullsi të crregjistrimeve edhe me dokumenta (kërkesa e studentit për crregjistrim, miratimi nga dekani si dhe vërtetimi i miratimit të crregjistrimit që e merr																						



të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.	studenti). Këto të dhëna ruhen edhe në sistem elektronik, Pitagora dhe menaxhohen nga sekretaria mësimore, por edhe në regjistrat fizik të programit të studimit të ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi". Sekretaria mësimore na vendosi në dispozicion dosjen personale të çdo studenti, e cila krijohet që në momentin e regjistrimit të tij dhe përditësohet me të dhëna të tjera përgjatë "jetës universitare" të tij në AU. Kjo dosje përditësohet edhe me elementë të tjerë si dokumentacioni i ndjekjes së praktikës profesionale, apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. GVJ gjatë inspektimit të rregjistrave themeltarë të studentëve të ciklit të Parë Bachelor në "Fizioterapi", të vëna në dispozicion nga sekretaria mësimore konstaton se ka raste të studentëve, që kanë transferuar studimet në AU, por ka dhe crregjistrime të cilat kishin procedurë të rregullt. Janë crregjistruar për vitin akademik; 2020-2021, 2 student; 2021-2022, 0 student; 2022-2023, 3 student; 2023-2024, 1 student Ref.1.1- Statuti i AU miratuar Korrik 2023.pdf Ref.1.1.a- Statuti i Albanian University.pdf Ref.1.2- Çertifikate akreditimi Institucionale 2023.pdf Ref.1.3.a- Rregullore e Albanian University.pdf Ref.1.4.b Plani strategjik Institucionale 2023-2028.pdf Reg.1.5 Rreg e Fakultetit të Shkencave Mjekesore (2).pdf Ref.1.7- VKM nr. 603, dt. 24.08.2011 Për ndryshimin e emrit të Universitetit.pdf Ref.1.8- Kodifikimi i programeve të studimit.pdf Ref.2.3 - Kurrikula e programit të studimit.pdfArbri Ref.2.4 - Dosja e praktikës profesionale për Bsc. Fizioterapi.pdf Ref.2.5 - Koordinator i programit të studimit.pdf Ref.2.6 - Syllabuset e lëndëve.pdf Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kritereve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf
Kriteri 3. Të dhënat statistikore të studentëve duhet të menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.	GVJ gjatë vizitës në institucion, RVB, referencave përkatëse konstatoi se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes një sistemi të brendshëm të informacionit nga Drejtoria e Kurrikulave dhe Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë si dhe nga sekretaria. Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. GVJ konstatoi se këto të dhëna janë të disponueshme në sekretarinë mësimore, në formë shkresore dhe elektronikisht në sistemin Pitagora, të cilat janë të verifikueshme nga personat e autorizuar, duke respektuar kuadrin ligjor për mbrojtjen e të dhënave, dhe që janë krijuar nga RASH dhe QSHA për të realizuar ruajtjen, administrimin dhe përpunimin e të gjitha të dhënave të studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe menaxhimin e aspekteve të funksionimit të AU.



	Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.21 Cilësia e studentëve në hyrje, dalje, rregjistrimet Ref.5. Tabelat përmbledhëse: Tabela Nr.23 Të dhëna për diplomimin dhe punësimin e studentëve në vite Ref.2.7 Vendim Senati për miratimin e kriterëve të pranimit.pdf Ref.2.8 Vendim Senati për miratimin e kuotave.pdf Ref.2.9 - Rregullore e Rregjistrimeve dhe Transferimeve.pdf
